

**MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS
DEPARTAMENTI I INSPEKTIMEVE**

**RAPORT
I INSPEKTIMIT MBI MENAXHIMIN E FLOTËS SË AUTOMJETEVE
DHE PAJISJEVE POLICORE**

Nr. 1/2017

Prishtinë, 25 shtator 2017

Informata të përgjithshme

Titulli	Raport i inspektimit mbi menaxhimin e flotës së automjeteve dhe pajisjeve policore
Data e përgatitjes	25 shtator 2017
Përgatitur nga	Mirsad Puqurica, inspektor (udhëheqës i ekipit) Fitore Gajraku, inspektor, Kadri Keçmezi, inspektor, Kushtrim Jonuzi, inspektor, Linda Ahmeti, inspektor, Servet Tasholli, inspektor, Shqiponjë Sopi, inspektor, Teuta Rukolli, inspektor, Xhavit Fetahaj, inspektor
Mbikëqyrur nga	Ilir Idrizaj, mbikëqyrës i inspektimit Udhëheqës i Divizionit të Inspektimit dhe Raportimit
Mbështetur nga	Bujar Mustafa, Udhëheqës i Divizionit për Analizë, Planifikim dhe Cilësi
Dorëzuar nga	Bekim Pira, Udhëheqës i Departamentit të Inspektimit
Miraturar nga	Hilmi Mehmeti, Kryeshef Ekzekutiv Inspektorati Policor i Kosovës
Data e miratimit	25 shtator 2017



1. Përmbledhja ekzekutive

- 1.1. Informacion i përgjithshëm mbi rezultatet e inspektimit.....(4-5)
- 1.2. Informacion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve.....(5-5)

2. Hyrje

- 2.1 Arsyet e inicimit të inspektimit.....(6-6)
- 2.2 Qëllimi i inspektimit.....(6-6)
- 2.3 Objekti i inspektimit.....(6-6)
- 2.4 Subjekti i inspektimit.....(6-6)
- 2.5 Objektivat e inspektimit.....(7-7)
- 2.6 Rëndësia e inspektimit.....(7-7)
- 2.7 Metodologjia e inspektimit.....(7-8)
- 2.8 Periudha e kryerjes së inspektimit.....(8-8)
- 2.9 Periudha e mbulimit të inspektimit.....(8-8)
- 2.10 Drejtimet e inspektimit.....(8-8)
- 2.11 Kriteret e vlerësimit.....(9-9)
- 2.12 Pengesat dhe kufizimet në arritjen e objektivave.....(9-9)

3. Përshkrimi i objektit, gjetjet dhe rekomandimet

- 3.1 Gjendja teknike e automjeteve policore.....(10-12)
- 3.2 Përdorimi, shpërndarja dhe kontrolli i automjeteve.....(12-15)
- 3.3 Performanca policore në procesin e mirëmbajtjes së automjeteve..(15-19)
- 3.4 Sigurimet dhe regjistrimet e automjeteve.....(19-21)
- 3.5 Aksidentet e trafikut me përfshirje të automjeteve policore.....(21-26)
- 3.6 Kushtet teknike të automjeteve për pjesëmarrje në qarkullim.....(26-27)

4. Plani për përmbushjen e rekomandimeve

- 4.1 Plani i veprimit për realizimin e rekomandimeve.....(28-31)

Shtojca

1. Përmbledhja ekzekutive

1.1. Informacion i përgjithshëm mbi rezultatet e inspektimit

1.1.1. Flota e automjeteve të PK-së përbëhet nga një fond automjeteve që sipas mesatares së derivuar nga gjendja teknike e tyre, rezultojnë të jetë të vjetëruar, por edhe të konsumuar në aspektin teknologjik. Përbëhet nga shumë tipe dhe modele, por edhe të mbetur në masë të madhe të pa përdorshme. Gjendja teknike e automjeteve në stacionet e vizituara ka rezultuar të jetë jo e kënaqshme, ngase një pjesë e madhe e automjeteve të kontrolluara kanë probleme teknike, duke shtruar nevojën për përmirësim të kësaj performace dhe angazhim të vazhdueshëm edhe të përdoruesve të tyre, mbikëqyrësve dhe shërbimeve të mirëmbajtjes. Organizata policore ka kryer një analizë mbi nevojën e zëvendësimit të vazhdueshëm të automjeteve, por kjo nismë kërkon mbështetje konkrete në të ardhmen, meqë çdo ngecie në realizimin e Planit të zëvendësimit ndikon edhe në ngecien e përbushjes së objektivit të Flotës për një Park efektiv. Është për t'u çmuar iniciativa për tjetërsimin e automjeteve përmes shitjes së tyre, por procesi të inicuar duhet dhënë shtytje drejt finalizimit dhe lirit të Parkut të automjeteve nga pasuria e pa përdorshme dhe jo funksionale, gjithmonë bazuar në rregullat në fuqi që përcaktojnë kriteret dhe procedurën për tjetërsimin e pasurive jo financiare.

1.1.2. IPK-ja ka vërejtur se kanë lëvizur gjërat pozitivisht drejt një mbikëqyrjeje të kënaqshme, në kontrollimin e automjeteve para përdorimit. Duhet vazhduar me kontroll të vazhdueshëm të tyre duke aplikuar një regjim të rregullt dhe duke përdorur formularë standard të kontrollimit ditor të tyre. Kësaj do t'i kontribuojë edhe shtimi i numrit të inspektimeve të pa paralajmëruara nga menaxhmenti brenda stacioneve dhe njësisve. Inspektorët janë të kënaqur me performancën e përdoruesve dhe të mbikëqyrësve në stacione rreth përbushjes së obligimeve që dalin nga plotësimi i informatave përbrenda formularit standard të Fletëudhëtimit, duke prezantuar në mënyrën e duhur përdorimin por edhe duke i kontribuar shfrytëzimit racional të automjeteve policore. Në aspektin higjienik është vërejtur një përmirësim i gjendjes në kontekstin e pastërtisë së tyre, me disa përjashtime që nuk dëmtojnë në masë evidente performancën e treguar policore. Andaj, inkurajohen përdoruesit dhe mbikëqyrësit që të vazhdojnë me përmirësimin e vazhdueshëm të gjendjes, për të fituar imazh pozitiv para qytetarëve. Është e nevojshme që me rastin e shpërndarjes së automjeteve tek drejtoritë dhe stacionet, të shikohet mundësia e një shpërndarjeje që nuk krijon kosto operative të lartë lidhur me hargjimet e derivateve, por edhe që është e përshtatshme për operim në raport me konfiguracionin gjeografik të zonës së përgjegjësisë së stacioneve. Ka raste kur përdoruesit dhe mbikëqyrësit nuk tregojnë kujdesin e duhur ndaj automjeteve policore, zakonisht në rastet kur ato është e nevojshme t'i nënshtrohen programit të mirëmbajtjes dhe vonohen duke krijuar mundësi reale për shfaqjen e defekteve shtesë që bartin kosto të pa nevojshme. Janë evidentuar raste kur automjetet e stacioneve, përkundër që munden të marrin shërbimet e serviseve në kuadër të serviseve të decentralizuara regjionale, në mënyrë të pa arsyeshme ngarkojnë Njësinë e Autoservisit Qendror me aktivitete të kësaj natyre dhe kjo ndikon negativisht në racionalizimin e shpenzimeve dhe kohës së punës.

1.1.3. IPK-ja çmon angazhimet e menaxhmentit të Flotës operative drejt minimizimit të numrit të mirëmbajtjeve tek kontraktorët e autorizuar dhe përpjekjet e vazhdueshme që të eliminohet tendenca e lirit të personelit mekanik nga një numër mirëmbajtjesh që mund të kryhen pa problem në Flotë. Në drejtim të aftësisë sa më të shpejtë të automjeteve që përkohësisht janë jashtë përdorimit, është e nevojshme që të kihet kujdes në tërheqjen me kohë të automjeteve që mirëmbahen nga Flota, ngase kjo i kontribuon shtimit të fondit të automjeteve aktive për punë operative. Duhet bërë përpjekje që

në bashkëpunim me akterët tjerë kontribuues, që të sanohet mangësia teknike në softverin e 'Road base' lidhur me informatat e plota edhe për mirëmbajtjet e operatorëve ekonomikë, në mënyrë që përmes një ri-modelimi të mundshëm që do t'i bëhej asaj, Flota operative për nevoja të saj dhe të PK-së, të mund të gjenerojë raporte mbi kostot e mirëmbajtjes për çdo automjet policor. Indikatorët e performancës tregojnë një rritje produktiviteti dhe efikasiteti të shërbimeve të mirëmbajtjes së automjeteve në raport me vitet e fundit edhe përkundër që Parku është vjetëruar, gjithmonë duke vlerësuar se largimi nga përdorimi i automjeteve jo funksionale do të freskonte edhe informacionin mbi gjendjen teknike të tyre. Pasqyra e shpenzimeve që lidhet me riparimet e pjesëve të automjeteve tek operatorët tregon ulje të kostove, gjë që bën që menaxhmenti të jetë i kënaqur me kursimet, por edhe kurioz të sigurohet se cili është 'çelësi i suksesit' që ka shtyrë këtë performancë. Kjo krijon idenë e verifikimit të kostove të viteve të fundit të kësaj kategorie shpenzimesh. IPK-ja vlerëson lartë angazhimet në uljen e shpenzimeve të furnizimit të pjesëve rezervë, gomave dhe riparimeve të pjesëve, duke kontribuar në racionalizimin e shpenzimeve të mirëmbajtjes së automjeteve dhe vënien në dispozicion të financave për projekte tjera me rëndësi operationale dhe kapitale.

1.1.4. Fusha e njoftimit me kohë të drejtorive rajonale, stacioneve dhe njësive policore mbi skadimin e regjistrimit të automjeteve kërkon përkushtim të vazhdueshëm të personelit, siç kërkohet edhe për regjistrimin me kohë të automjeteve policore, me gjithë disa lëvizje pozitive të vitit të fundit të Zyrës së Regjistrimeve dhe Sigurimeve (ZRS).

1.1.5. Është vlerësuar e pa pranueshme performanca në fushën e përfshirjes së automjeteve zyrtare në aksidente trafiku dhe kjo konsiderohet performanca më negative e viteve të fundit, që shtron nevojën e ndërmarrjes së hapave serioz drejt ngritjes së sigurisë së përgjithshme në trafik dhe disiplinimit të përdoruesve të automjeteve policore. E pa pranueshme është edhe tendenca e mos raportimit me kohë në Zyrën e Aksidenteve (ZA), e aksidenteve dhe incidenteve me përfshirje policore, duke bërë që pasuria policore të mos trajtohet në mënyrën e duhur, duke treguar shenja neglizhence dhe pa përgjegjësie të njësive policore në raportimin me kohë, siç përcaktohet me rregullat në fuqi. IPK-ja vlerëson se mbikëqyrësit duhet t'u përmbahen obligimeve në kuadër të përgjegjësive që kanë, për të ndërmarrë hapat e duhur në disiplinimin e vartësve për rastet kur supozohet se janë kontribuues të aksidenteve, ngase në këtë mënyrë rritet llogaridhënia dhe nuk kalojnë gjërat në heshtje pa ndërmarrë asgjë. Duke iu referuar të dhënave që derivojnë nga dosjet e aksidenteve dhe të atyre disiplinore, shtrohet nevoja e ngritjes së përgjegjësisë së përdoruesve të automjeteve gjatë pjesëmarrjes në trafik, për të kontribuar në reduktimin e aksidenteve me pjesëmarrje policore dhe në ngritjen e sigurisë së përgjithshme në trafik.

1.1.6. Inspektorët kanë kontrolluar pajimin e automjeteve të stacioneve policore të inspektuara me pajisje dhe dokumente operationale dhe kanë vlerësuar se automjetet në masën 93% janë të pajisur me aparate kundër zjarrit, 99% me kuti të ndihmës së parë, 95% me trekëndësh të paralajmërimit, 95% me polica të sigurimit dhe 92% me raporte të aksidenteve.

1.2. Informacion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve

1.2.1. Nga inspektimi i kryer ka rezultuar se nga 11 rekomandime të lëna në dy (2) inspektimet e kaluara (inspektimet nr. 05/2014 dhe 02/2015), një (1) prej tyre është realizuar plotësisht, tre (3) janë përmbushur në masën më të madhe (përgjithësisht), një (1) është realizuar pjesërisht dhe gjashtë (6) nuk janë përmbushur (për më tepër referoju tabelës në shtojcën 1 dhe 2).

2. Hyrje

2.1. Arsyet e inicimit të inspektimit

2.1.1. Në bazë të Ligjit nr. 03/L-231, Inspektorati Policor i Kosovës (IPK) ka mandat ligjor që të kryejë inspektime në Policinë e Kosovës (PK), për të vlerësuar mënyrën e kryerjes së detyrave policore. Ky aktivitet ndihmon dhe mbështetë Policinë, për të siguruar një shërbim profesional, demokratik dhe të përgjegjshëm. Plani Vjetor i Inspektimeve të Rregullta të Departamentit të Inspektimit (2017) ka përfshirë kryerjen e inspektimeve në disa fusha menaxhimi, përfshirë edhe menaxhimin e flotës së automjeteve dhe pajisjeve policore. Inspektimi i kësaj fushe të menaxhimit paraqet fushë me interes për IPK-në, sepse bart risk për shkak të përdorimit të automjeteve të përcjellur me kosto të lartë dhe paraqet një nga investimet më të kushtueshme të organizatës policore. Prandaj, është nevoja që një transport policor i sigurt, i besueshëm dhe i qëndrueshëm, të jetë i balancuar me menaxhimin efektiv të këtyre burimeve shumë të shtrenjta. Duke kuptuar rëndësinë e kësaj fushe, Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së me datë 24 maj 2017, mbi bazën e Programit të miratuar të punës inspektuese të datës 23 maj 2017, ka inicuar një inspektim për të vlerësuar performancën policore në këtë fushë të menaxhimit.

2.2. Qëllimi i inspektimit

2.2.1. Qëllimi i këtij inspektimi është:

- Që të përcaktojë nëse ligjet, rregulloret dhe parimet e procedurat policore përkatëse zbatohen si duhet dhe janë të përshtatshme për të arritur qëllimet e saj,
- Që të përcaktojë nëse burimet policore shfrytëzohen në mënyrë efektive, efikase dhe se janë të përshtatshme për të arritur qëllimet dhe objektivat e saj,
- Që të jepet një opinion objektiv mbi çështjet që lidhen me këtë fushë të menaxhimit,
- Që të parandalojë shkeljet eventuale që mund të kryhen gjatë veprimtarisë së PK-së në fushën përkatëse,
- Të identifikojë mangësitë apo dobësitë dhe të rekomandojë masa ligjore dhe organizative për funksionimin më të mirë të PK-së.

2.3. Objekti i inspektimit

2.3.1. Në këtë inspektim të rregullt do të vlerësohet kryerja e detyrave policore në fushën e menaxhimit të flotës së automjeteve dhe pajisjeve policore.

2.4. Subjekti i inspektimit

2.4.1. Inspektimi do të përqendrohet në Flotën Operative, në kuadër të Drejtorisë së Logjistikës dhe në sektorët e administratës së stacioneve policore.

2.5. Objektivat e inspektimit

2.5.1. Objektivat që synon t'i arrijë ky inspektim janë:

- Të analizohet dhe përcaktohet gjendja teknike e automjeteve përgjatë ciklit jetësor të tyre,
- Të vlerësohet mënyra e shpërndarjes së automjeteve sipas kritereve të përcaktuara,
- Të analizohet dhe vlerësohet respektimi i procedurave dhe efikasiteti i punës së Flotës operative gjatë procesit të mirëmbajtjes të automjeteve,
- Të vlerësohet niveli i përkujdesit të punonjësve policorë ndaj automjeteve policore,
- Të vlerësohet respektimi i afateve lidhur me sigurimin dhe regjistrimin e automjeteve,
- Të vlerësohet niveli i pajimit të automjeteve me pajisjet dhe dokumentet e nevojshme.

2.6. Rëndësia e inspektimit

2.6.1. Inspektimi në këtë fushë të menaxhimit luan rol të rëndësishëm në:

- Ushtrimin e një kontrolli adekuat për të siguruar shkallë më të lartë të transparencës, ekonomizimit, efikasitetit dhe leverdisë ekonomike të shfrytëzimit të automjeteve,
- Ngritjen e përgjegjësisë së punonjësve në përdorimin dhe ruajtjen e automjeteve,
- Ngritjen e vetëdijes policore për të ndikuar në minimizimin e rasteve të shfrytëzimit jo të përgjegjshëm, jo racional dhe jo të duhur të automjeteve,
- Ngritjen e besimit të qytetarëve mbi shfrytëzimin e mjeteve të siguruar nga taksat e tyre.

2.7. Metodologjia e inspektimit

2.7.1. Gjatë inspektimit:

- a) Janë zhvilluar intervista dhe takime me 37 punonjës policorë, si në vijim:
 - Udhëheqësin e Departamentit të Shërbimeve Mbështetëse,
 - Drejtorin e Drejtorisë së Logjistikës,
 - Udhëheqësin e Flotës Operative,
 - Udhëheqësin e Njesisë së Autoservisit të Flotës Operative,
 - Zyrtarin e Zyrës së Aksidenteve,
 - Zyrtarin e Zyrës së Regjistrimeve dhe Sigurimeve,
 - Komandantët e stacioneve policore (në mungesë të tyre, Zyrtarët e logjistikës).
- b) Janë kryer vëzhgime, këqyrje apo kontrollime të dosjeve, si në vijim:
 - Janë kontrolluar kartelat për verifikimin e procesit të mirëmbajtjes (2015/2016),
 - Janë kontrolluar rreth 100 automjete, lidhur pajisjet dhe dokumentet e nevojshme,
 - Janë kontrolluar të gjitha dosjet e aksidenteve për vitet (2015/2016),
 - Është verifikuar dorëzimi i pjesëve të ndërruara, të konsideruara si jo funksionale.
- c) Janë plotësuar formularët e inspektimit lidhur me:
 - Pajimin e automjeteve me pajisjet dhe dokumentet e nevojshme,
 - Respektimin e procedurave të mirëmbajtjes nga personeli i Flotës,
 - Nxjerrjen e informatave nga dosjet e aksidenteve.

- d) Janë siguruar dëshmitë, si në vijim.
- Dëshmi mbi koston e mirëmbajtjes dhe koston blerëse të automjeteve,
 - Raporti me të dhëna mbi vjetërsinë dhe kilometrazhën për të gjitha automjetet,
 - Raporti mbi numrin e automjeteve të furnizuara dhe atyre të vlerësuara për shitje,
 - Dëshmi mbi proceset e vlerësimit të automjeteve për shitje, komisionet vlerësuese, listat e automjeteve dhe historikun e tyre,
 - Dëshmi mbi shpërndarjen e automjeteve policore,
 - Dëshmitë mbi historikun e automjeteve dhe koston totale të riparimeve,
 - Raportet mujore të mirëmbajtjes të Flotës operative dhe serviseve të autorizuara,
 - Kopjet e raporteve të stokut për pjesët e ekzaminuara, bashkë me kopjet e faturave të operatorëve që kanë kryer shërbimet e mirëmbajtjes me vlera mbi 1.000 €
 - Kopjet e faturave të shërbimeve të mirëmbajtjes dhe kopjet e kontratave,
 - Kopjet e faturave të shërbimeve të serviseve, që kanë pjesët nën garancion,
 - Kopjet e njoftimeve mbi skadimin e sigurimeve dhe regjistrimeve,
 - Kopjet e sigurimeve/regjistrimeve për automjetet që janë inspektuar,
 - Raporti mbi numrin e aksidenteve dhe incidenteve për dy (2) vitet e fundit,
 - Dëshmi mbi inicimet e brendshme të procedurave administrative dhe disiplinore,
 - Raportet e stacioneve policore me të dhëna mbi numrin e përgjithshëm të automjeteve në posedim, automjeteve në servis dhe automjeteve në funksion, dhe
 - Dokumente tjera relevante për të vlerësuar performancën policore.

2.8. Periudha e kryerjes së inspektimit

2.8.1. Bazuar në Programin e punës inspektuese, inspektimi ka filluar me datë 29.05.2017 dhe ka përfunduar më datë 14.06.2017.

2.9. Periudha e mbulimit të inspektimit

2.9.1. Inspektimi është përqendruar në vlerësimin e kryerjes së detyrave policore gjatë periudhave kalendarike janar-dhjetor 2015 dhe janar-dhjetor 2016. Veç tjerash, inspektimi është fokusuar edhe në gjendjen aktuale, siç është rasti i kontrollimit të automjeteve.

2.10. Drejtimit e inspektimit

2.10.1. Për përmbushjen e objektivave, inspektimi është fokusuar në këto drejtime kryesore:

- Gjendja teknike e automjeteve policore (funksionaliteti),
- Përdorimi, shpërndarja dhe kontrolli i automjeteve,
- Performanca policore në procesin e mirëmbajtjes së automjeteve,
- Sigurimet dhe regjistrimet e automjeteve,
- Aksidentet e trafikut me përfshirje të automjeteve policore,
- Kushtet teknike të automjeteve për pjesëmarrje në qarkullim.

2.11. Kriteret e vlerësimit

2.11.1. Dokumentet në vijim janë baza, në të cilën është mbështetur puna e inspektorëve, gjatë vlerësimit të kryerjes së detyrave në departamentet, drejtoritë, stacionet apo njësitë policore:

- Ligji nr. 04/L-076 për Policinë,
- Ligji nr. 02/L-070 për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor,
- Ligji nr. 02/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor,
- Udhëzimet Administrativ nr. 19/2014, 23/2015, 16/2016 për Regjistrimin e Automjeteve,
- Udhëzimi Administrativ nr. 03/2008 për Përdorimin e Automjeteve të Qeverisë,
- Udhëzimi Administrativ nr. 06/2012 për Shkeljet, Masat e Procedurat Disiplinore në PK,
- Rregullorja për Personel dhe Administratë në Policinë e Kosovës,
- Rregullorja nr. 02/13 për Menaxhimin e Pasurisë Jo-financiare në Organizata Buxhetore,
- Doracakun 'Parimet dhe Procedurat e Policisë',
- Procedurat Standarde të Operimit për Flotën Operative (PSO: DL-03).

2.12. Pengesat dhe kufizimet në arritjen e objektivave

2.12.1. IPK-ja vlerëson se gjatë punës në terren dhe pasqyrimin të gjetjeve në raportin e zgjeruar të inspektimit, nuk ka hasur në ndonjë vështirësi që do të ndikonte në përmbushjen me sukses të objektivave të vëna me Programin e punës inspektuese.

3. Përshkrimi i objektit, të gjeturat dhe rekomandimet

3.1. Gjendja teknike e automjeteve policore

3.1.1. Parku i automjeteve i PK-së përbëhet nga 1.546 automjete¹, që përfaqësohen nga 153 tipe dhe 38 modele. Moshë mesatare e Parkut të automjeteve është llogaritur të jetë rreth 10 vjet, kurse në historikun e saj shihen gjurmë të automjeteve që nga viti 1982. Afërsisht 78,4% e Parkut është më e vjetër se shtatë (7) vite, kurse, mesatarja e përdorimit të automjeteve arrin në rreth 190.000 km të kaluara për çdo automjet. Janë identifikuar 14 automjete që janë përdorur për më shumë se 500.000 km. Një analizë e kryer nga menaxhmenti i Flotës operative pasqyron se nga gjithsej 1.529 automjete të evidentuara në fund të vitit 2016, vetëm 967 prej tyre janë në funksion të plotë (63.2%), derisa 437 (28.6%) janë propozuar për përfshirje në proces tjetërsimi² dhe 125 të tjera (8,2%) gjenden në proces të mirëmbajtjes. Ekziston një numër automjete, vlera e riparimit të të cilave ka tejkaluar kriteret e përcaktuara për tjetërsim. Janë evidentuar 24 automjete, vlera e riparimit të të cilave është më e madhe ose e barabartë me vlerën e tregut të kësaj pasurie. IPK-ja vlerëson se Parku si segment kapital i kushtueshëm është ndikuar nga politikat financiare, planifikuese, prokuruese, rrethanat dhe faktorët që kanë pasur impakt në organizatë nga themelimi, duke kaluar në fazën e tranzicionit e deri në periudhën pas shpalljes së pavarësisë. Vlerësohet se që nga themelimi i organizatës, politikat zhvillimore strategjike nuk kanë trajtuar në masën e duhur problemet, me të cilat është ballafaquar Parku. PK-ja duhet nxjerrë strategji adekuate për funksionimin dhe mbajtjen e Parkut, dhe konform objektivave dhe aktiviteteve të vendosura, t’iu jepet përgjigje problemeve që atakojnë mirë funksionimin. Trajtimi i duhur i temave me interes që lidhen me funksionimin e Parkut, kërkon nevojën për mobilizim të nivelit strategjik organizativ në nxjerrjen e Strategjisë për sigurimin e një Parku funksional, por edhe atij operativ në mbajtjen efikase, racionale dhe ekonomike të funksioneve (blerje, kontroll, mirëmbajtje, operim) që lidhen me Parkun.

Moshë sipas grupeve (vite)		Numri i automjeteve (1.546)	%	Kilometrazha sipas grupeve		Numri i automjeteve (1.520 ³)	%
Prej	Deri			Prej	Deri		
0	7	333	21.6	0	100.000	402	26.4
7	14	1.051	67.9	100.000	200.000	426	28.0
14	21	125	8.1	200.000	300.000	421	27.7
21	28	9	0.6	300.000	400.000	208	13.7
28	35	28	1.8	400.000	500.000	49	3.2
				mbi 500.000		3	0.9

¹ Numri prej 1.546 automjeteve rezulton nga të dhënat e muajit korrik të vitit 2017, të gjeneruara nga menaxhmenti i Flotës operative.

² Ministria e Financave, *Rregullore MF nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore*, termin ‘tjetërsim i pasurisë’ e përkufizon si shitje të pasurisë, dhurimin apo asgjësimin, proces pas të cilit organizata nuk ka pronësi dhe mbikëqyrje mbi pronën e tjetërsuar.

³ Në numrin prej 1.546 automjeteve që buron nga të dhënat e muajit korrik 2017, nuk janë përfshirë 26 rimorkio, të cilat nuk kanë matës të kilometrave dhe nuk u dihen kilometrat e kaluara gjatë përdorimit të tyre.

3.1.2. Inspektorët janë interesuar të dijnë për gjendjen teknike të automjeteve dhe kanë inspektuar 100 automjete funksionale që kanë qenë prezente në stacione policore të inspektuara. Pas kontrollit të kryer është konstatuar se prej 100 automjeteve të kontrolluara, 40 prej tyre (40%) kanë rezultuar me probleme të natyrës teknike, derisa 60 të tjera (60%) nuk kanë pasur probleme teknike që mund të vërehen vizualisht. Te automjetet policore që janë vlerësuar me gjendje jo të mirë teknike, janë vërejtur dëmtime të karrosierisë dhe dritave (25 raste), mosfunksionim i klimave, sinjalizimit dhe alarmit (10 raste), probleme të sistemit të frenimit dhe marshit (4 raste), mungesë të logos policore (2 raste), mungesë të radiove të komunikimit (5 raste) dhe dëmtime të ulëseve apo rripit të sigurisë (3 raste), etj. Doracak i Parimeve dhe Procedurave të Policisë, në Parimin P-10.01, tek kapitulli I (Procedurat e mirëmbajtjes së automjeteve), ka përcaktuar përgjegjësitë dhe obligimet që dalin mbi mirëmbajtjen e automjeteve zyrtare policore. Inspektorët kanë vlerësuar se kjo gjendje e pa pranueshme teknike e automjeteve, ka ardhur si rezultat i neglizhencës së punonjësve policorë, zyrtarëve për mirëmbajtjen e automjeteve në kuadër të stacioneve policore dhe mbikëqyrësve. Gjendja jo e mirë teknike e automjeteve mund të ketë shumë efekte negative, por më kryesore konsiderohet probabiliteti për të rrezikuar drejtuesit e automjeteve në trafik dhe rënia e imazhit policor për shkak të pamjes së pa pranueshme të automjeteve gjatë ekspozimit të tyre në rrugë.

Rekomandimi nr. 1

IPK-ja u rekomandon të gjithë mbikëqyrësve, zyrtarëve të mirëmbajtjes dhe përdoruesve të automjeteve zyrtare në stacione policore, që gjithëherë të ndërmarrin veprimet e nevojshme rreth deklarimit dhe procedimit të automjeteve zyrtare në procedurë të mirëmbajtjes, kur vërejnë se gjendja teknike e tyre nuk përkon me standardin e kërkuar, me qëllim të aftësisë të tyre operativ, ofrimit të sigurisë në rrugë dhe ngritjes së imazhit policor.

3.1.3. PK-ja ka nxjerrë një Projekt analizë⁴ me një vlerësim mbi nevojat për automjetet policore për funksionimin normal të saj. Dokumenti ka marrë parasysh gjendjen e përgjithshme dhe aktuale të automjeteve, menaxhimin e automjeteve, nevojat për funksionim të duhur të Parkut, nevojat në nxjerrjen e planeve për mirë funksionimin e Parkut dhe planifikimin financiar për të ardhmen. PK-ja ka përdorur një formulë për vendosjen e një optimumi të nevojshëm të automjeteve, duke marrë parasysh aktivitetet patrulluese, ato hetimore dhe administrative, bazuar në praktikën më të mira dhe nevojat e organizatës. Sipas kësaj formule, nevojat e PK-së sillen për rreth 1.100 automjete, bazuar në kriterin funksional të gjendjes aktuale të Parkut (afërsisht nëse nuk llogarisim në automjetet jo funksionale të proceduara për tjetërsim, Parku momentalisht ka 967 automjete funksionale dhe 125 të tjera që janë në procedurë të mirëmbajtjes). Bazuar në politikën e zëvendësimit të automjeteve, Analiza e kryer nga menaxhmenti i Flotës operative potencon nevojën e zëvendësimit të automjeteve për çdo vit me nga 137 automjete të reja, duke marrë parasysh që njëherit çdo vit të tjetërsohen po aq sa përmbushin kriteret për tjetërsim, gjithmonë duke u bazuar në kriteret e përcaktuara me Rregulloren (MF) nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jo-financiare në Organizata Buxhetore. IPK-ja ka vërejtur se respektimi i Planit të zëvendësimit për dy (2) vitet e fundit nuk është mbështetur me veprime konkrete, ngase freskimi i Parkut me automjete të reja nuk përcjell trendin e nevojshëm sipas formulës së zëvendësimit, për shkak të ndikimit të disa faktorëve, përfshirë kufizimet buxhetore dhe procedurat e prokurimit. IPK-ja mbështet kryerjen e analizave të kësaj natyre duke shqyrtuar faktorët dhe nevojat për funksionimin e Parkut, ngase ndihmojnë në funksionimin e duhur të tij.

⁴ Drejtoria e Logjistikës, *Projekt analizë mbi vlerësimin e nevojave për automjete për PK-në (2016-2020)*.

Rekomandimi nr. 2

IPK-ja i rekomandon menaxhmentit të lartë të PK-së që në planet e ardhshme strategjike të vendosin me prioritet objektiva dhe veprime që orientojnë organizatën në adresimin e çështjeve që ndihmojnë në mirë funksionimin e Parkut të automjeteve.

3.1.4. IPK-ja nuk ka hasur në dëshmi se mund të ketë pasur ndonjë proces tjetërsimi gjatë viteve 2015 dhe 2016. Gjatë vitit 2017 është inicuar një proces i tillë, që nuk është përmbyllur ende, ngase një Komision i ngritur për vlerësim të automjeteve ka dalur me një Raport⁵ me rekomandim për tjetërsim të një numri të konsiderueshëm të automjeteve dhe të njejtin ia ka prezantuar Zyrtarit Kryesor Administrativ (ZKA). Gjatë kontrollimit të Raportit, vërehet se atij i mungojnë të dhënat mbi koston e mirëmbajtjes dhe vlerën neto kontabël të automjeteve të propozuara për tjetërsim. Një gjë tjetër që vërehet në këtë proces është të bazuarit në kriterin e 'tejkalimit 75% të koston së mirëmbajtjes në raport me koston blerës të automjetit'. PSO-ja në fuqi për punën e Flotës operative nuk duket se ka marrë për bazë Rregulloren në fuqi mbi Menaxhimin e Pasurive Jo-financiare në Organizata Buxhetore. Vlerësohet se deri tek kjo gjendje e Parkut të automjeteve (e trashëguar), të karakterizuar me një fond të automjeteve të stërvjetëruara që në shumë raste ka tejkaluar kufijtë e mirëmbajtjes në raport me koston blerëse, ka ardhur si rezultat i qasjes dhe vlerësimit jo serioz dhe mos gatishmërisë për të trajtuar këtë fushë të ndjeshme, e cila ka sjellë Parkun në një 'varrezë' automjetesh. IPK-ja vlerëson se kjo gjendje ndikon në rënien e funksionalitetit të Parkut, krijon shpenzime operative të mirëmbajtjes dhe krijon humbje kohe në proceset e mirëmbajtjes. IPK-ja çmon punën e Komisionit të vlerësimit të pasurisë, duke besuar se procedimi i mëtejshëm i iniciativës do të rezultojë me finalizim të procesit të tjetërsimit, duke liruar Parkun nga kontigjenti i automjeteve jo funksionale.

Rekomandimi nr. 3

IPK-ja i rekomandon Zyrtarit Kryesor Administrativ që të shtyjë proceset drejt tjetërsimit të kësaj pasurie, bazuar në kriteret dhe procedurat e përcaktuara me Rregulloren (MF) nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jo-Financiare në Organizata Buxhetore dhe Planin e zëvendësimit të automjeteve, për të siguruar që PK-ja të ketë një Park funksional të automjeteve, të mbështetur me fond të mjaftueshëm të automjeteve dhe të mirëmbajtur në mënyrë efikase dhe ekonomike.

3.2. Përdorimi, shpërndarja dhe kontrolli i automjeteve

3.2.1. Udhëzimi Administrativ nr. 02/2008 për përdorimin e automjeteve të Qeverisë së Kosovës, në nenin 6, paragrafi 6.4 dhe nenin 7, paragrafi 7.2 ka përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë në kontrollimin e automjeteve para përdorimit. Po ashtu, edhe Doracaku i Parimeve dhe Procedurave, në Parimin P-10.01 që ka të bëjë me shfrytëzimin e automjeteve, ka përcaktuar përgjegjësitë dhe detyrat e mbikëqyrësve dhe përdoruesve të automjeteve në mirëmbajtjen ditore sipas formularit të listës së verifikimit të automjetit. Aplikimi i kontrolleve apo inspektimeve të automjeteve para përdorimit është duke u aplikuar më kënaqshëm se në të kaluarën, por jo edhe rregullisht çdo ditë nga një numër stacionesh policore. Kurse, kontrollet javore të automjeteve nga menaxhmenti janë të rregullta dhe evidente në të gjitha stacionet policore të inspektuara. Shumë stacione policore kanë praktikuar edhe kontrollet e jashtëzakonshme, të kohëpaskohshme, drejt rritjes së kujdesit në

⁵ Komisioni për Vlerësimin e Veturave të PK-së, *Raporti i vlerësimit të automjeteve*, 19.05.2017, Prishtinë.

shfrytëzimin e tyre. Është vërejtur se në rastet e kontrollimit të automjeteve përdoren formularë të ndryshëm. IPK-ja vlerëson se mos aplikimi i përditshëm i kontrollimit ditor të automjeteve në një numër stacionesh policore rezulton nga neglizhenca e përdoruesve dhe tendenca e tyre për të konsideruar këtë aktivitet si ngarkesë dhe rutinë, në raport me angazhimet e tyre operative. IPK-ja inkurajon mbikëqyrësit dhe përdoruesit që të respektojnë kriterin e përcaktuar për kontrollimin ditor të tyre, duke besuar se i shërben mirëmbajtjes, si dhe kujdesit të duhur të automjeteve. Është e nevojshme që të aplikohet një formular standard i kontrollimit, bazuar në dokumentet ligjore në fuqi.

3.2.2. Udhëzimi Administrativ nr. 02/2008 për përdorimin e automjeteve të Qeverisë së Kosovës, në nenin 6, paragrafi 6.3 ka përcaktuar obligimin që ka çdo drejtues i automjetit zyrtar që në Fletëudhëtim të shënojë numrin e kilometrave të automjetit në momentin e nisjes, destinacionin e udhëtimit, qëllimin e udhëtimit, numrin e kilometrave të kaluara në momentin e kthimit dhe nënshkrimin e përdoruesit. Inspektorët kanë kontrolluar formularët e përdorimit ditor të më se 100 automjeteve policore dhe kanë vërejtur se të gjitha automjetet përdorin formularët e tillë. Kjo performancë ka rrjedhur nga serioziteti i përdoruesve në shfrytëzimin e automjeteve. Punonjësit policorë inkurajohen të vazhdojnë të tregojnë seriozitet drejt prezantimit të informatave të plota në formularët e përdorimit ditor të automjeteve, duke ndikuar pozitivisht në vendosjen e kontrollit më të rreptë të përdorimit të tyre.

3.2.3. Inspektorët janë interesuar të vlerësojnë gjendjen higjienike të automjeteve të inspektuara në stacione policore dhe me këtë rast kanë vlerësuar gjendjen higjienike të automjeteve zyrtare. PSO-ja për Flotën Operative ka përcaktuar se ‘mbikëqyrësi i secilës njësi që posedon automjete, duhet të sigurohet që ato të pastrohen në mënyrë periodike, jashtë dhe brenda, që t’i mirëmbahet pamja’. Doracak i Parimeve dhe Procedurave në Parimin P-10.01 kur flitet për procedurën e mirëmbajtjes, në pikën 4 potencon se ‘policët dhe mbikëqyrësit e tyre janë personalisht përgjegjës për gjendjen e automjetit që ata drejtojnë’. Më tutje, Parimi potencon se ‘automjetet duhet të mirëmbahen sipas një standardi të lartë të prezantimit’. Pas kontrollimit të automjeteve zyrtare, është konstatuar se prej 100 automjeteve të inspektuara, 11 (11%) prej tyre kanë rezultuar të papastra në aspektin higjienik, derisa 89 (89%) sosh kanë qenë në gjendje të mirë higjienike. Mos kujdesi ndaj automjeteve në rastet e indentifikuara ka ardhur si pasojë e neglizhencës dhe kontrollit jo të mjaftueshëm të mbikëqyrësve dhe përdoruesve. IPK-ja vlerëson se trajtimi jo adekuat i automjeteve zyrtare në aspektin higjienik ndikon në rënien e imazhit para qytetarëve dhe vështirëson ambientin e punës.

Rekomandimi nr. 4

IPK-ja u rekomandon komandantëve të stacioneve që të ushtrojnë kontroll më të shpeshtë mbi përdoruesit e automjeteve dhe zyrtarët kompetent të mirëmbajtjes, në mënyrë që automjetet gjatë ekspozimit në rrugë, të paraqesin imazh pozitiv para qytetarëve.

3.2.4. Shpërndarja e automjeteve për njësitë kërkuese udhëhiqet nga menaxhmenti i lartë i PK-së. Shpërndarja bëhet siç autorizohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë, duke u bazuar në kërkesat operacionale dhe mundësitë e realizimit të kërkesave për automjete policore. Inspektorët kanë siguruar dëshmitë e shpërndarjes së një kontigjenti të automjeteve dhe është vlerësuar se ato janë shpërndarë me iniciativë të Udhëheqësit të Departamentit të Shërbimeve Mbështetëse (ZKA). Shpërndarja e automjeteve është bërë për nivelin rajonal të drejtorive, kurse shpërndarjen në nivel

të stacioneve policore kanë udhëhequr drejtoritë rajonale policore, bazuar në nevojat e stacioneve dhe njësive policore. Gjatë shpërndarjes së automjeteve të reja janë përdorur formularët e pranid-dorëzimit që kanë përmbajtur edhe pajisjet me të cilat janë ngarkuar ato. Inkurajohet menaxhmenti i PK-së që në rastet tjera, para shpërndarjes së automjeteve të marrin parasysh dy situata që do t'i kontribuonin menaxhimit të duhur të Parkut të automjeteve. *E para*, do të ishte praktikë e mirë që në bashkëpunim me Flotën operative të shqyrtohet mundësia e futjes në veprim të sistemit të lëvizjes (rrotacionit) së automjeteve me më pak apo më shumë kilometra në raport me vitin e prodhimit, nga stacioni (njësia) në stacion (njësi), në mënyrë që para procesit të tjetërsimit të mund të merren parasysh apo përmbushen proporcionalisht kriteret, si vjetërsia dhe përdorueshmëria (kostoja e mirëmbajtjes). *E dyta*, që në njësitë apo stacionet që nuk kanë terren të pa përshtatshëm gjeografik në zonën e tyre të përgjegjësisë, të mos shpërndahen automjete që përmbajnë parametra apo specifika teknike që ngarkojnë koston e mirëmbajtjes (mirëmbajtjen dhe hargjimet operative).

3.2.5. Gjatë inspektimit është vërejtur një dukuri e faktuar në së paku 24 raste, kur mbikëqyrësit dhe përdoruesit e automjeteve nuk përfillin rregullat mbi mirëmbajtjen e automjeteve, gjë që bën që ato të mos gëzojnë kujdesin e duhur nga përdoruesit. Doracaku në Parimin P-10.01, kapitulli I, pika 1 ka përcaktuar se 'çdo dëmtim në automjet duhet të paraqitet tek Zyrtari i logjistikës së stacionit. Polici i logjistikës duhet ta paraqes dëmin tek Flota e automjeteve të PK-së'. Sipas Doracakut, në kapitullin E, pika 7, është përcaktuar përgjegjësia e komandantit, drejtuesit dhe Zyrtarit të logjistikës, në deklarimin e defekteve në automjete, duke siguruar që defektet apo problemet mekanike, të mos neglizhohen duke rrezikuar paraqitjen e defekteve tjera shtesë. IPK-ja ka identifikuar 24 raste kur automjetet zyrtare janë ngasur përkundër njohurive të zyrtarëve për nevojën e mirëmbajtjes së tyre. IPK-ja vlerëson se vonesat në futjen e automjeteve në program të mirëmbajtjes për servis të rregullt apo edhe për shkak të defekteve, më shumë kanë ardhur si neglizhencë e përdoruesve dhe mbikëqyrësve dhe mos interesimit të tyre për të mbajtur automjetet në gjendje të duhur. Kjo ka efekt negativ në trajtimin e pasurisë policore dhe ndikon negativisht në rënien e fuqisë aktive të Parkut, rritë shpenzimet për shkak të kostos shtesë të defekteve që bartin dhe rrisin kohën e punës për të eliminuar defektet. IPK-ja inkurajon personelin e Flotës operative që të shfrytëzojë të drejtën për ndaljen e automjeteve deri në inicimin e procedurës së brendshme disiplinore, për rastet tek të cilat vëren se nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme nga shfrytëzuesit e automjeteve për t'u përdorur në mënyrën më ekonomike dhe më efikase.

Rekomandimi nr. 5

IPK-ja u rekomandon mbikëqyrësve, zyrtarëve të mirëmbajtjes së automjeteve dhe përdoruesve të tyre që të kujdesen për gjendjen teknike të automjeteve dhe sipas nevojave t'i dërgojnë në proces të mirëmbajtjes, duke mbrojtur dhe u kujdesur për to, si aset me rëndësi operationale.

3.2.6. Me gjithë funksionimin e serviseve regjionale, vërehet se dukuria e dorëzimit të automjeteve të drejtorive rajonale në Njësinë e Autoservisit në kuadër të Flotës operative nuk është e rrallë. PSO-të në fuqi kanë përcaktuar kryerjen e disa llojeve të serviseve në servise regjionale. Inspektorët kanë identifikuar 24 raste kur njësitë policore kanë dërguar automjetet në servis qendror. Automjetet e tilla që janë dorëzuar në Flotën operative duke anashkaluar serviset rajonale, janë identifikuar dhe i janë prezantuar PK-së. IPK-ja vlerëson se është e pa arsyeshme të ndodhë një gjë e tillë, sepse krijon humbje kohe, ngarkon pa arsye servis qendror me angazhime shtesë dhe njëherësh krijon shpenzime të derivateve për të dorëzuar automjetin në Flotë.

Rekomandimi nr. 6

IPK-ja u rekomandon mbikëqyrësve, zyrtarëve të mirëmbajtjes së automjeteve dhe përdoruesve të tyre që në rastet kur disa lloje të mirëmbajtjeve mund të kryhen në servise rajonale, të shmangin situatat e pa nevojshme, duke ngarkuar servisin qendror me angazhime shtesë për mirëmbajtjen e automjeteve të tyre.

3.3. Performanca policore në procesin e mirëmbajtjes së automjeteve

3.3.1. Për të verifikuar se sa respektohen rregullat dhe procedura e mirëmbajtjes së automjeteve, janë kontrolluar kartelat e punës sipas mostrës së përcaktuar. Inspektorët janë shërbyer me rregullat dhe procedurën e mirëmbajtjes së automjeteve të rregulluar me PSO. Fokusi kryesor ka qenë të vlerësohet respektimi i rregullave dhe procedurave gjatë pranimit të automjeteve nga njësia kërkuese, caktimit të mekanikut, hapjes së kartelave të punës, caktimit të komisionit inspektues, evidentimit të prishjes, kontaktimit të Depos së pjesëve rezervë të Flotës Operative, nënshkrimit të fletës së punës për rastet e dërgimit të automjeteve tek operatorët e kontraktuar, kontrollimit të automjetit nga komisioni verifikues pas kthimit nga servisi i autorizuar, konfirmimit të pranimit dhe dorëzimit të pjesëve, mbylljes së kartelës të punës dhe dorëzimit të automjetit policor. Janë identifikuar disa raste edhe pse në numër shumë më të vogël në krahasim me vitet e kaluara, të përcjelljes së automjeteve në serviset e autorizuara, me gjithë faktin se për ndërrimin e pjesëve të tyre, Depoja dhe Autoservisi ka mundur të sigurojë pjesët dhe shërbimet (04463/16, 04296/15, 04345/15). PSO përcakton procedurën që duhet ndjekur për automjetet që dërgohen në serviset e autorizuara. Ekzaminimi i një numri shërbimesh të kryera nga kontraktorët, vë në pah se ende ka raste edhe pse në numër të vogël, që nuk kontaktohet Depoja e pjesëve nga personeli i Autoservisit mbi disponueshmërinë e pjesëve rezervë. Inspektorët kanë verifikuar stokun e pjesëve rezervë dhe kanë vlerësuar se mos verifikimi i Depos ka ardhur si rezultat i neglizhimit nga personeli i Njesisë së Autoservisit. IPK-ja vlerëson tendencën e minimizimit të rasteve të dërgimit të automjeteve tek serviset e autorizuara kur nuk disponohet me pjesët e nevojshme dhe inkurajon që t'i bëhet shtytje edhe më tej proceseve drejt racionalizimit të shërbimeve dhe shpenzimeve. Lidhur me fazat e procesit të mirëmbajtjes, vërejtjet kryesore fokusohen tek vonesat në pranimin e automjeteve të mirëmbajtura nga njësitë që dorëzojnë automjetet. Vërehet se një numër automjetesh nuk tërhiqen menjëherë pas kryerjes së shërbimeve. Janë identifikuar 24 raste kur edhe përkundër njoftimit se janë kryer riparimet apo servisimet e automjeteve, njësitë policore që kanë dorëzuar automjetet, nuk i kanë tërhequr me kohë ato nga Njësia e Autoservisit. Vonesat në tërheqjen e automjeteve kanë ardhur si rezultat i neglizhimit dhe jo seriozitetit në punë nga punonjësit e autorizuar të njësive që kanë dorëzuar automjetet. Tërheqja me vonesë e automjeteve policore nga procesi i mirëmbajtjes zvogëlon kapacitetet apo fuqinë aktive të Parkut të automjeteve, duke zvogëluar fondin e automjeteve për punë operative të njësive.

Rekomandimi nr. 7

IPK-ja u rekomandon të gjithë menaxherëve policorë të stacioneve, drejtorive, divizioneve dhe departamenteve që të shtojnë përpjekjet e tyre në mënyrë që personeli kompetent i shërbimeve mbështetëse, të tërheqë në kohë të duhur automjetet nga procesi i mirëmbajtjes, duke mundur ngritjen e fuqisë aktive apo fondit të automjeteve policore në funksion.

3.3.2. Flota operative ka në funksion një bazë elektronike të të dhënave 'Road base', në cilën kanë qasje punonjësit e saj, varësisht nga modulet përkatëse. Kjo Bazë vërehet se nuk ka mundësinë të gjenerojë në raporte edhe informacionin mbi vlerën e shërbimeve dhe pjesëve të ndërruara nga operatorët ekonomikë. Sipas menaxhmentit, kjo rezulton nga kapaciteti i kësaj Baze, i cili kërkon ri-modelim në drejtim të ngritjes së kapaciteteve të saj. Dobësia apo mangësia e Bazës për të ofruar dhe mirëmbajtur këtë lloj informacioni, ndikon negativisht në mbajtjen evidencave të sakta mbi historikun e mirëmbajtjes së automjeteve apo kostos investive të automjeteve. Menaxhmenti i Flotës operative ka nevojë që vazhdimisht të jetë i pajisur me informata mbi koston dhe historikun e automjeteve, me qëllim të vlerësimit të funksionalitetit, drejt marrjes së hapave për tjetërsim të kësaj pasurie. Kjo problematikë vështirëson marrjen e vendimeve në kohë të duhur, andaj nevojitet ndërmarrje e veprimeve drejt përmirësimit të kapaciteteve softverike të sistemit të informacionit.

Rekomandimi nr. 8

IPK-ja i rekomandon menaxhmentit të Flotës operative, Drejtorit të Logjistikës dhe Udhëheqësit të Departamentit të Shërbimeve Mbështetëse që të shqyrtojnë mundësinë në bashkëpunim me Drejtorinë e Teknologjisë Informative, në ngritjen e kapaciteteve të Bazës së të dhënave, në mënyrë që të dhënat mbi mirëmbajtjen e automjeteve të jenë më të plota, duke mundësuar lehtësim në marrjen e vendimeve në interes të Parkut të automjeteve.


3.3.3. Analiza mbi trendet e suksesit përgjatë dy viteve të fundit tregon se efikasiteti në kryerjen e shërbimeve ka qenë i ndryshueshëm. Gjatë vitit 2015 është vërejtur trend negativ me tendencë të rënies së efikasitetit, që ka filluar nga viti 2014 dhe ka vazhduar deri në tremujorin e fundit të vitit 2015. Derisa në vitin 2013, një automjet ka qëndruar mesatarisht në Flotë deri në 5.53 ditë, në vitin 2014 kjo mesatare vjetore ka arritur në 9.99 ditë, duke arritur pikën kritike prej 11.68 ditë në vitin 2015. Kjo mesatare është ulur përgjatë vitit 2016, duke shënuar shifrën 7.56 ditë për automjet. Në krahasim me vitin 2015, kur numri i ditëve të qëndrimit të automjeteve në proces të mirëmbajtjes kishte arritur në gjithsej 119.041 ditë, ky numër shënon rënie në vitin 2016, në gjithsej 73.684 ditë, që afërsisht është 38% ditë më pak të humbura në proces të mirëmbajtjes së automjeteve. Flota ka shënuar trend afërsisht të njëjtë të mirëmbajtjes ditore të automjeteve, që përgjatë viteve të fundit silltet nga 37-39 automjete të mirëmbajtura në ditë. Të dhënat e vitit 2015 pasqyrojnë se deri në aftësimin e automjeteve, mesatarisht 326 automjete janë gjendur jashtë funksioni duke qenë të tërhequra përkohësisht nga përdorimi, derisa në vitin 2016, ky numër është zvogëluar në 201⁶. Nëse marrim parasysh numrin e përgjithshëm të automjeteve në funksion (1.529 sosh⁷) në raport me numrin e përgjithshëm të ditëve të qëndrimit të automjeteve në procedurë të mirëmbajtjes, gjatë vitit 2015, 21% e kapaciteteve aktive të Flotës kanë qenë pasive, kurse, në vitin 2016, kjo shifër silltet në 13%. Lëvizjet në përmirësimin e performancës kanë ardhur si rezultat i menaxhimit më efikas të Flotës, seriozitetit në punë, mbylljes me kohë të kartelave të punës, sigurimit të pjesëve rezervë dhe menaxhimit më të mirë të kontratave me operatorët ekonomikë që ofrojnë shërbime të mirëmbajtjes. Përkundër vjetërsimit të vazhdueshëm të fondit të automjeteve, vitin e fundit është ngritur efikasiteti në mirëmbajtjen e automjeteve, por që mbetet ende për t'u dëshiruar në krahasim me vitin 2013, kur Flota kishte një performancë më pozitive. Trendi pozitiv që ka rezultuar nga

⁶ Kalkulimet kanë marrë parasysh mosfunksionimin e automjeteve policore gjatë 365 ditëve kalendarike (numri i përgjithshëm ditëve të qëndrimit të automjeteve në servis në raport me numrin e ditëve kalendarike).

⁷ Numri i automjeteve prej 1529 sosh paraqet numrin e përgjithshëm të automjeteve funksionale policore sipas evidencave të 31 dhjetorit 2016, të siguruar nga zyrtarët e Flotës.

fundi i vitit 2015 dhe ka vazhduar gjatë tërë vitit 2016, ka pasur për rrjedhojë ngritjen e fuqisë aktive të automjeteve, duke bërë që numri i automjeteve pasive të ulet, duke siguruar fond më të madh të automjeteve për punë. IPK-ja vlerëson angazhimet e menaxhmentit dhe personelit të Flotës në ndaljen e performancës jo të duhur që ishte evidente në periudhën 2014-15 dhe inkurajon edhe më tej ngritjen e efikasitetit në mirëmbajtjen e automjeteve (tabela 2).

Tabela nr. 2. Pasqyra e indikatorëve të performancës në mirëmbajtjen e automjeteve (2015/2016)				
Indikatorët e performancës	Periudha (viti)			
	2013	2014	2015	2016
Numri i kartelave të hapura në Flotë	10.052	10.245	10.327	9.816
Numri i kartelave të mbyllura	9.838	10.016	10.191	9.646
Numri i kartelave të pa mbyllura	214	229	136	170
Numri i ditëve të qëndrimit në Flotë	54.452	100.137	119.041	73.684
Mesatarja e numrit të ditëve të qëndrimit në Flotë	5.53	9.99	11.68	7.56
Mesatarja e numrit të automj. të mirëmbajtura në ditë	38	39	39	37
Mesatarja e numrit të automjeteve jo aktive	149	274	326	201




3.3.4. PSO e Flotës operative ka përcaktuar edhe fushën e dorëzimit të pjesëve të ndërruara në Depo. Inspektorët kanë kontrolluar një numër kartelash të punës dhe kanë vërejtur se mbi kthimet e pjesëve të ndërruara, mbahen evidenca në formularë standard (Pjesët e vjetra të kthyera në Depo) dhe nënshkruhen nga personeli që kthen pjesët. Për pjesët e vjetra të grumbulluara, Udhëheqësi i Flotës ka praktikuar inicimin e punës së komisioneve të verifikimit të pjesëve të ndërruara që mund të largohen nga Depoja, si pjesë të vjetra dhe të pa përdorshme. Komisionet janë mbledhë varësisht nga sasia e pjesëve të grumbulluara, duke ndarë pjesët për mbeturina, që largohen nga kompania e kontraktuar. Dorëzimi i pjesëve të ndërruara paraqet shembull të mirë të menaxhimit të Flotës, drejt shtritjes së kontrollit mbi pjesët rezervë. Kjo metodë e zbatuar zvogëlon gjasat për të lënë

hapësirë për keqpërdorim eventual të menaxhimit të pjesëve. IPK-ja inkurajon menaxhmentin e Flotës që të vazhdojë me realizimin e këtyre evidencave dhe verifikimeve, drejt një menaxhimi më të mirë dhe të sigurtë të pjesëve të përdorura, si dëshmi që pjesët rezervë janë futur në përdorim.

3.3.5. Nëse krahasojmë indikatorët e performancës së Flotës operative të viteve të fundit, shumë nga ta pasqyrojnë një ngritje të efikasitetit dhe ekonomizimit të shërbimeve. Viti 2016 rezulton të jetë viti me performancën më të mirë në katër (4) vitet e fundit. Shërbimet e operatorëve, kostot e pjesëve dhe gomave kanë shënuar rënie. Shërbimet e mirëmbajtjes tek kontraktorët kanë rënë në vitin 2015 për 24.6% në krahasim me vitin paraprak, kurse në vitin 2016 për 91.2% në krahasim me vitin paraprak. Kosto e pjesëve rezervë në vitin 2015 kanë pësuar rënie për 37.7% në krahasim me vitin paraprak, kurse në vitin e fundit trendi rënës ka vazhduar edhe për 45.2% në krahasim me vitin 2015. Viti 2016 ka shënuar vitin më ekonomik sa i përket edhe kostos së gomave të reja. Shpenzimet e kësaj kategorie në vitin 2015 kanë rënë për 47.4% në krahasim me vitin 2014, kurse viti 2016 është edhe për 41.4% më ekonomik se viti 2015. Rënie kanë shënuar edhe hargjimet e derivateve që për vitin 2015 janë më të ulëta për 0.3% në krahasim me vitin 2014 dhe për 1% më të ulëta në vitin 2016 në krahasim me vitin paraprak. Nëse u referohemi hargjimeve të derivateve, rezulton se në vitin 2014, një (1) automjet ka hargjuar mesatarisht 2.996 litra në vit apo 8.13 litra në ditë. Në vitin 2015, kjo mesatare bie në 2.890 litra në vit apo 7.92 litra në ditë. Hargjimet e derivateve kanë shënuar rënie edhe në vitin 2016, që sillet në 2.771 litra në vit apo 7.59 litra në ditë për automjet. Indikator suksesi është edhe numri mesatar i automjeteve që kanë operuar aktivisht gjatë vitit, numër ky që është rritur nga viti në vit, duke filluar në vitin 2014 kur ka qenë 862, në vitin 2015 ka qenë 882 dhe vitin e fundit ka qenë 911. Treguesit e performancës tregojnë se viti 2014 ka qenë viti më i kushtueshëm për Parkun në aspektin financiar, kurse viti i fundit ka rezultuar të jetë viti më ekonomik. Kjo performancë ka ardhur si rezultat i reduktimit të serviseve tek kontraktorët, furnizimit me automjete që kanë shpenzime më ekonomike, racionalizimit të shpenzimeve për pjesë rezervë, mobilizimit të menaxhmentit dhe ngritjes së kontrollit. Kur krahasohen indikatorët, vërehet se Parku ka pasur në dispozicion fond më të madh të automjeteve aktive të përcjellur me racionalizim të shpenzimeve. IPK-ja inkurajon menaxhmentin e Flotës në përpjekjet për të siguruar një menaxhim efikas të Parkut, çfarë e kanë pasqyruar indikatorët në vitet e fundit (tabela 3).

Tabela nr. 3. Indikatorët e performancës së Flotës operative në fushën e mirëmbajtjes (2015/2016)				
Indikatorët e performancës	Periudha (viti)			
	2013	2014	2015	2016
Hargjimet e derivateve (litër)	2.594.251,27	2.556.603,24	2.549.308,95	2.524.564,63
Kosto e mirëmbajtjes te serviset (€)	448.919,42	471.811,72	355.726,22	31.365,49
Kosto e furnizimit me pjesë (€)	1.015.903,9	1.198.499,91	747.021,92	409.687,18
Kosto e furnizimit me goma (€)	318.815,00	334.489,00	175.878,62	102.993,57
Mesatarja e automjeteve aktive⁸	863	862	882	911
Hargjimi mesatar ditor i derivateve për automjet (litër)	8.23	8.13	7.92	7.59

⁸ Mesatarja e numrit të automjeteve aktive është nxjerrë nga raportet e hargjimeve mujore të derivateve të automjeteve, të dhëna këto të përpunuara nga personeli administrativ i Flotës operative.



3.3.6. Bazuar në indikatorët e suksesit me trend të ngritjes së efikasitetit të Flotës në kryerjen e shërbimeve të mirëmbajtjes duke reduktuar në masë të madhe shërbimet e kontraktorëve, IPK-ja është interesuar të trajtojë problematikën se si mund të ngritet efikasiteti i Flotës, duke reduktuar këto shërbime. Mostër për trajtim janë përzgjedhur shërbimet kontraktuale të riparimit të një numri të pjesëve të automjeteve policore, si: riparimi i turbinave, riparimi i bosh-pompave, riparimi i gypave të hidraulikut, shpimi/ frezimi i bllokut të motorit, rrafshimi/ testimi dhe frezimi i kokës së motorit, riparimi i injektorëve, rrafshimi dhe testimi i kokës së motorit, etj. Të dhënat tregojnë se numri i pjesëve të riparuar tek kontraktorët ka shënuar rënie, nga 138 sa ishte në vitin 2014, në 109 në vitin 2015 dhe në 31 në vitin 2016. Edhe shpenzimet e këtyre riparimeve kanë rënë nga 33.410 € sa ishin në vitin 2014, në 27.020 € në vitin 2015 dhe 8.519,39 € në vitin 2016. IPK-ja inkurajon menaxhmentin në uljen e shpenzimeve të riparimit të pjesëve të automjeteve, por shtron nevojën e kryerjes së një analize apo verifikimi, që do të merr parasysh se si është menaxhuar kjo problematikë në vitet që kanë shënuar shpenzime të larta të kësaj kategorie në krahasim me vitin e fundit. Shtrohet nevoja e një verifikimi brenda organizatës mbi shumat e shpenzuara dhe nevojat për shërbimet e tilla të riparimit, për të siguruar se në të kaluarën, shërbimet e riparimeve të pjesëve të automjeteve kanë qenë të arsyeshme, të nevojshme dhe të menaxhuara si duhet. Ky aktivitet do të kishte efekt pozitiv në eliminimin e dobësive eventuale të mundshme të procesit të mirëmbajtjes, racionalizimin e shpenzimeve dhe shtrirjen e një kontrolli më efikas mbi nevojat dhe kërkesat.

3.4. Sigurimet dhe regjistrimet e automjeteve policore

3.4.1. Inspektorët kanë verifikuar nëse kryhen me kohë njoftimet mbi skadimin e regjistrimeve të automjeteve. Janë siguruar kopje të kontrolleve teknike, sigurimeve dhe librezave të automjeteve të më se 100 automjeteve të inspektuara në stacione dhe informatat e mangëta janë verifikuar në ZRS. Janë kontrolluar njoftimet e dërguara nga ZRS-ja, tek autoritetet rajonale. Njoftimet mbi

skadimin e regjistrimeve shpërndahen tek stacionet përmes drejtorive rajonale. PSO në fuqi përcakton që ‘ZRS-ja është e obliguar që 30 ditë para se të skadojë regjistrimi i automjeteve dhe i sigurimit, të lajmërojë të gjitha njësitë e PK-së, si dhe njëherë 15 ditë para skadimit, t’i ri-kujtojë zyrtarët e logjistikës në kuadër të DPP-së dhe DRP-ve për skadimin e regjistrimit të automjeteve’. Lidhur me njoftimin për skadimin e afatit të vlefshmërisë së regjistrimeve është konstatuar se ZRS-ja nuk ka respektuar afatet kohore të njoftimeve të bëra në pjesën më të madhe të tyre për dy (2) vitet e fundit. Nga 38 raste të njoftimeve për skadim të regjistrimit të automjeteve për vitin 2015, ka rezultuar se në 18 prej tyre nuk është plotësuar standardi i kërkuar me PSO. Në vitin 2016, këto shifra arrijnë në 41 raste nga gjithsej 56. Trendi pasqyron rënie të performancës së ZRS-së në krahasim me vitin 2015. Nëse marrim performancën e ZRS-së përgjatë viteve të fundit, shohim se viti 2012 dhe 2016 kanë performancë më të dobët në krahasim me vitin 2013 dhe 2015. IPK-ja vlerëson se ngritja e numrit të rasteve të njoftimeve me vonesë, sidomos në vitin e fundit, ka ardhur si rezultat i volumit të punëve, me të cilat ngarkohet ZRS-ja. Mosnjoftimi me kohë i stacioneve policore dhe njërive tjera policore mund të ndikojë në paraqitjen e vonesave në regjistrimin me kohë të automjeteve policore. IPK-ja inkurajon menaxhmentin në kryerjen e një analize mbi nevojën e shtimit të personelit në kryerjen e këtyre aktiviteteve ose shqyrtimin e ndërmarrjes së hapave drejt lirimimit të ZRS-së nga kjo përgjegjësi, me kusht që përcjellja e aktiviteteve rreth skadimit të regjistrimeve të automjeteve, të bartet nën përgjegjësinë e zyrtarëve të logjistikës në kuadër të administratës së stacioneve, divizioneve dhe drejtorive policore (tabela 4).

Tabela nr. 4. Të dhëna përmbledhëse mbi performancën policore në respektimin e procedurave lidhur me njoftimin dhe regjistrimin e automjeteve (2015/2016)								
Indikatorët	Viti 2012		Viti 2013		Viti 2015		Viti 2016	
	Numri	%	Numri	%	Numri	%	Numri	%
Njoftimet me kohë	34 (106)	32.1	72 (130)	55.4	20 (38)	52.6	15 (56)	26.8
Vonesat në njoftime	72 (105)	67.9	58 (130)	44.6	18 (38)	47.4	41 (56)	73.2
Regjistrimet në kohë	81 (105)	77.1	88 (127)	69.3	28 (39)	71.8	52 (59)	88.1
Vonesat në regjistrime	24 (105)	22.9	39 (127)	30.7	11 (39)	28.2	7 (59)	11.9
Vonesat e paarsyetuara	16 (24)	66.7	34 (39)	87.2	9 (11)	81.8	5 (7)	71.4


3.4.2. Ligji në fuqi për Siguri në Komunikacionin Rrugor përcakton se ‘çdo mjet motorik, traktor, çiklomotor ose mjet bashkëngjitës, i lejoheq që të merr pjesë në komunikacion rrugor nëse posedon lejen e komunikacionit të vlefshme, ndërsa mjetet të cilat janë të regjistruara në Kosovë edhe librezën e mjetit’. Udhëzimet administrative nr. 19/2014, 23/2015 dhe 16/2016 për Regjistrimin e Automjeteve që kanë rregulluar fushën e regjistrimit të automjeteve për periudhën që ka qenë objekt inspektimi, kanë përcaktuar se ‘kërkesa për vazhdimin e regjistrimit mund të bëhet maksimalisht 15 ditë para kalimit të afatit të regjistrimit të mëparshëm’. Sipas Udhëzimit në fuqi, ‘Qendra e Regjistrimit të Automjeteve (QKA) është e obliguar të bëjë vazhdimin e regjistrimit të automjetit nga data e skadimit të afatit të regjistrimit’. Janë siguruar librezat e qarkullimit dhe për automjetet që janë regjistruar me vonesë janë siguruar konfirmimet e ZRS-së për një pjesë të vonesave që kanë rezultuar nga nënshtrimi i tyre në procedurë mirëmbajtjeje. Automjetet që nuk janë regjistruar me kohë, por që kanë qenë në servis, nuk janë përfshirë në grupin e automjeteve të regjistruara me vonesë. Sipas procedurave në fuqi, ZRS-ja ngarkon njësitë shfrytëzuese të automjeteve që të kryejnë kontrollimet teknike, për të vazhduar me procedurën e sigurimit dhe regjistrimit. Bazuar në të gjeturat e vitit 2015, 11 automjeteve nga gjithsej 39, nuk iu është kryer

me kohë regjistrimi dhe nëntë (9) prej tyre nuk u arsyetohen vonesat e shkaktuara. Në vitin 2016, shtatë (7) automjeteve nga gjithsej 59, nuk iu është kryer me kohë regjistrimi dhe 5 prej tyre, nuk u arsyetohen vonesat e shkaktuara. Ka rënë numri i rasteve të automjeteve të regjistruara me vonesë, që krahasuar me katër (4) vitet e fundit paraqet performancën më të mirë të ZRS-së në regjistrimin me kohë të automjeteve. Ky trend ka ardhur si rezultat i mobilizimit dhe përkushtimit të personelit në kryerjen e detyrave. Ngritja e efikasitetit në regjistrimin e automjeteve minimizon mundësitë që automjetet të operojnë të pa regjistruara dhe të pa siguruar. IPK-ja inkurajon personelin e ZRS-së që të shtojë përpjekjet në zvogëlimin e mëtejshëm të rasteve të regjistrimit me vonesë të automjeteve.

3.5. Aksidentet e trafikut me përfshirje të automjeteve policore

3.5.1. Duke analizuar trendin e pesë (5) viteve të fundit mbi përfshirjen e automjeteve policore në aksidente/ incidente, del se performanca policore ka arritur në pikën më kritike duke bërë që viti i fundit të jetë viti me numrin më të madh të tyre. Numri i aksidenteve dhe incidenteve me përfshirje policore në vitin 2016 është ngritur në gjithsej 370 raste, që është për 12.12% më i lartë se në vitin 2012 kur ishte realizuar një performancë e dalluar si më negative në pesë (5) vitet e fundit (330 raste) dhe për 33.09% më i lartë se viti 2014 (278 raste), i regjistruar si viti me numrin më të ulët të aksidenteve/ incidenteve në pesë (5) vitet e fundit. Aksidentet kanë arritur në një nivel afërsisht të njëjtë me vitin 2012, por që është për 27.16% më i lartë se në vitin 2014 kur numri i përgjithshëm i aksidenteve kishte shënuar nivelin më të ulët të rasteve. Trendi me tendencë të ngritjes së numrit të rasteve dhe përgjegjësia (fajësia) e vlerësuar në gjysmën e numrit të përgjithshëm të rasteve të ndodhura, shtron nevojën e kryerjes së analizave nga vetë menaxherët mbi faktorët që kanë ndikim në shtimin e numrit të aksidenteve por edhe përgjegjësisë së punonjësve, që për tërë këto vite vazhdon të jetë prezente në rreth gjysmën e rasteve të regjistruara. IPK-ja vlerëson se trendi negativ i përfshirjes së automjeteve policore në aksidente/ incidente ka ardhur si rezultat i pa përgjegjësisë së punonjësve policorë në konsiderimin e pronës policore si një mjet i rëndësishëm i kryerjes së detyrave. Trendi negativ që ka rezultuar gjatë vitit 2016, ka pasur për rrjedhojë rënien e fuqisë aktive të automjeteve, duke zvogëluar fondin e automjeteve zyrtare për punë operative, duke rritur gjasat për shtimin e shpenzimeve dhe kohës së punës që humbet për aftësimin e tyre (tabela nr. 5).

Tabela nr. 5. Të dhëna mbi trendin e aksidenteve/incidenteve me automjete policore (2015/2016)										
Viti	Aksidente	Përgjegjësia në aksidente				Incidente	Përgjegjësia në incidente			
		Fajtor	%	Jo fajtor	%		Fajtor	%	Jo fajtor	%
2012	313	143	45.68	170	54.31	17	0	0	17	100
2013	286	144	50.34	142	49.65	31	1	3.22	30	96.77
2014	243	108	44.44	135	55.55	35	0	0	35	100
2015	244	120	49.18	124	50.81	83	0	0	83	100
2016	309	151	48.86	158	51.13	61	0	0	61	100



Rekomandimi nr. 9

IPK-ja u rekomandon menaxherëve policorë që të shtojnë përpjekjet në sigurimin e masave adekuate dhe ngritjen e përgjegjësisë së vartësve gjatë shfrytëzimit të automjeteve policore, duke konsideruar kujdesin ndaj automjeteve si angazhim për të ruajtur pronën policore si aset që mundëson kryerjen e detyrave operative.


3.5.2. Duke analizuar trendin e viteve të fundit lidhur me raportimin me kohë të aksidenteve/incidenteve, del se performanca policore ka arritur pikën më kritike në vitin 2016. Duke filluar nga viti 2012 e deri në vitin 2016, numri i rasteve të raportimit me kohë të aksidenteve/incidenteve me përfshirje të automjeteve policore ka pësuar rënie të vazhdueshme. PSO-ja në fuqi ka përcaktuar afatin prej dhjetë (10) ditëve të punës brenda të cilave duhet raportuar ndodhja e aksidenteve dhe incidenteve. Derisa në vitin 2012, afërsisht gjysma e rasteve të ndodhura janë raportuar në Zyrën e Aksidenteve brenda afateve të përcaktuara, në vitet 2013 dhe 2015, numri i rasteve të raportuara përtej afatit 10 ditor ka shënuar ngritje duke arritur në 60%. Trendi negativ i raportimit në vitin 2016 ka arritur pikën më negative të viteve të fundit, duke arritur në kuotën prej 69%, që tregon se afërsisht çdo i treti automjet i aksidentuar raportohet brenda afateve kohore (tabela nr. 6). Menaxhmenti i Flotës duhet të sigurohet se menaxherët dhe zyrtarët e stacioneve dhe drejtorive, të angazhuar në mirëmbajtjen e automjeteve janë në dijeni të ekzistimit të PSO-së që rregullon fushën e raportimit të aksidenteve/ incidenteve. Analiza nga të dhënat e Road Base⁹ dhe evidencat fizike nga dosjet e aksidenteve kanë nxjerrë se mesatarisht një aksident apo incident i ndodhur, në vitin 2016 është raportuar mesatarisht në të 32-tën ditë nga ndodhja e rastit. Kjo performancë është më e dobët në krahasim me vitin 2012/13, kur IPK-ja ka kryer matjet e fundit, e që kishte rezultuar me raportimin e aksidenteve/ incidenteve të ndodhura, mesatarisht në të 24-tën ditë. IPK vlerëson se ky trend negativ i performancës është rezultat i pa përgjegjësisë dhe neglizhencës së punonjësve kompetent të nivelit lokal, regjional dhe qendror në raportimin e rasteve. Trendi negativ ka pasur për rrjedhojë rënien e fuqisë aktive të automjeteve dhe rritë papërgjegjshmërinë e punonjësve dhe menaxherëve në raportimin e rasteve, etj.

⁹ Road Base është Bazë elektronike e të dhënave mbi mirëmbajtjen e automjeteve policore që administrohet nga zyrtarët e Flotës operative të Drejtorisë së Logjistikës.

Tabela nr. 6. Të dhëna përmblledhëse mbi shkallën e raportimit të aksidenteve dhe incidenteve me përfshirje të automjeteve zyrtare (2015/2016)

Indikatorët	Periudha krahasimore				
	2012	2013	2014	2015	2016
Numri i aksidenteve dhe incidenteve	330	317	278	327	370
Numri i rasteve të raportuara deri në 10 ditë pune	164	128	NA	131	115
%	50	40	NA	40	31
Numri i rasteve të raportuara përtej 10 ditëve të punës	166	189	NA	196	255
%	50	60	NA	60	69
Kufiri mesatar ditor i raportimit të rasteve (në ditë)	24	24	NA	30	32

Diagrami 3. Trendi i raportimit të aksidenteve dhe incidenteve



Rekomandimi nr. 10


IPK-ja u rekomandon menaxherëve dhe zyrtarëve kompetent të mirëmbajtes së automjeteve të tri niveleve të strukturës organizative policore, që të ngrisin performancën policore në raportimin me kohë të aksidenteve dhe incidenteve, në drejtim të ngritjes së përgjegjësisë në ruajtjen e pronës policore, ngritjes së kapaciteteve aktive të Parkut të automjeteve dhe minimizimit të tendencës për shmangie apo mosdeklarim të rasteve të ndodhura.

3.5.3. Doracaku i Parimeve dhe Procedurave të Policisë ka përcaktuar se ‘për çfarëdo keqpërdorimi apo pakujdesie gjatë përdorimit të automjetit policor e që rezultojn me dëmtim, humbjen apo nevojën për riparim, duhet të bëhen hetime nga njësitë të cilit i takon’¹⁰. Sipas Doracakut, ‘ky hetim duhet t’i referohet Drejtorisë së Standardeve Profesionale’. Po ashtu, Parimi P-1.50 rregullon edhe përgjegjësinë e inicimit të procedurës disiplinore nga mbikëqyrësit tek DSP-ja për t’iu nënshtruar masave disiplinore dhe suspendimit në rast se konstatohet se ngasësit e automjeteve policore kanë kryer kundërvajtje nga pakujdesia apo keqpërdorimi. Udhëzimi Administrativ nr. 06/2012 për Shkeljet, Masat dhe Procedurat Disiplinore përcakton procedurën që duhet ndërmerret lidhur me

¹⁰ Policia e Kosovës, *Doracaku i Parimeve dhe Procedurave*, Parimi P-1.50 (Dëmtimi i automjeteve të SHPK-së), Procedura, B, faqe 81.

inicimet e brendshme¹¹. Të gjeturat kanë vënë në pah një dukuri të mos inicimit të procedurave disiplinore tek një numër rastesh apo aksidentesh ku supozohet se ka fajësi nga radhët e punonjësve policore si drejtues të automjeteve të përfshirë në aksidente. Nëse marrim totalin e aksidenteve të supozuar me fajësi për vitin 2015 del se për 120 aksidente të tilla, janë inicuar gjithsej 74 procedura të brendshme disiplinore për dëmtim të pronës policore (61.6%) dhe për 46 raste nuk janë gjetur dëshmi se janë inicuar procedura të tilla (38.4%). Nga gjithsej 74 procedura të inicuar disiplinore, katër (4) kanë rezultuar me vendime për pafajësi (5.4%), 13 raste janë në proces (17.6%), kurse 57 raste kanë rezultuar me fajësi për shkaktim të aksidenteve (77%). Kurse, në vitin 2016 për 151 aksidente të tilla janë inicuar 106 procedura disiplinore për dëmtim të pronës policore (70.2%) dhe për 45 raste nuk është gjetur dëshmi se janë inicuar procedura disiplinore (29.8%). Nga gjithsej 106 procedura të inicuar disiplinore, pesë (5) kanë rezultuar me vendime për pafajësi (4.7%), 38 janë në proces (35.8%) kurse 63 kanë rezultuar me fajësi të punonjësve për shkaktim të aksidenteve (59.4%). Mosinicimi i procedurave të brendshme vë në mëdyshje seriozitetin e mbikëqyrësve në trajtimin e duhur të kësaj problematike, drejt disiplinimit të vartësve në përdorimin e duhur të automjeteve. Kjo tendencë krijon situata që gjërat të kalojnë në heshtje pa u trajtuar dhe rritë gjasat që automjetet policore të mos shfrytëzohen me kujdesin e nevojshëm.

Tabela nr. 7. Të dhëna të përgjithshme mbi indikatorët e performancës në fushën e inicimit të disiplinës së brendshme për dëmtim prone gjatë aksidenteve me automjete policore (2015/2016)											
Numri i aksidenteve të supozuara me fajësi		Numri i rasteve të inicuar		Numri i rasteve të pa inicuar		Numri i rasteve të mbyllura si të pa fajshëm		Numri i rasteve në proces		Numri i rasteve të kryera me vendim për fajësi	
2015	2016	2015	2016	2015	2016	2015	2016	2015	2016	2015	2016
120	151	74	106	46	45	4	5	13	38	57	63




¹¹ Policia e Kosovës, *Udhëzimi Administrativ nr. 06/2012 për Shkeljet, Masat dhe Procedurat Disiplinore në PK*, neni 42 (inicimet e brendshme), kapitulli IV-Procedurat disiplinore, faqe 53.

Rekomandimi nr. 11

IPK-ja u rekomandon mbikëqyrësve që të ndër marrin veprimet e nevojshme drejt disiplinimit të ngasësve policorë të automjeteve, me qëllim të ngritjes së vetëdijes policore në trajtimin si dhe shfrytëzimin e duhur të pasurisë policore.

3.5.4. Doracaku i Parimeve dhe Procedurave të Policisë në Parimin P-1.50 përcakton se të gjithë vozitësit janë përgjegjës për përdorimin e drejtë dhe të sigurtë të automjeteve policore¹². Kurse, Parimi P-10.01 te përgjegjësitë e vozitësit përcakton se ‘shoferi i automjetit të PK-së duhet gjithnjë të jetë shembull pozitiv për publikun derisa drejton automjetin e PK-së dhe t’i respektoj të gjitha rregullat e trafikut’¹³. Inspektorët kanë trajtuar fushën e përgjegjësisë së punonjësve në aksidentet me përfshirje të automjeteve policore. Janë nxjerrë dëshmitë nga Zyra e Aksidenteve për rastet tek të cilat është vlerësuar se ka fajësi të supozuar për shkaktim aksidenti. Numri i këtyre rasteve ka qenë gjithsej 271 për dy (2) vitet që janë objekt inspektimi (120 raste për vitin 2015 dhe 151 për vitin 2016). Inspektorët kanë identifikuar se tre (3) shkaktarët më të shpeshtë të aksidenteve janë ‘manipulimi i pasigurt me automjet’ që përfaqësohet me 28 raste nga gjithsej 57 raste të mbyllura me fajësi në vitin 2015 (49.1%), ‘mospërshtatja e shpejtësisë ndaj kushteve të rrugës dhe atyre klimatike’ përfaqësohet me pesë (5) raste (8.8%) dhe ‘mosmbajtja e distancës në mes automjeteve’ me katër (4) raste (7%). Në vitin 2016, ‘manipulimi i pasigurt me automjet’ përfaqësohet me 23 raste nga gjithsej 63 raste të mbyllura me fajësi (36.5%), ‘mospërshtatja e shpejtësisë ndaj kushteve të rrugës dhe atyre klimatike’ përfaqësohet me katër (4) raste (6.4%) dhe ‘mosmbajtja e distancës në mes automjeteve’ përfaqësohet me tre (3) raste (4.8%). IPK-ja kupton angazhimet e punonjësve policorë në përmbushjen e detyrave të përditshme që mund të përcillen edhe me situata jo të këndshme, por inkurajon ata që të shtojnë vigjilencën drejt respektimit të rregullave të trafikut rrugor, në mënyrë që të mos rrezikohet siguria e përgjithshme e pjesëmarrësve në trafik.



¹² Policia e Kosovës, *Doracaku i Parimeve dhe Procedurave*, Parimi P-1.50 (Dëmtimi i automjeteve të SHPK-së), Procedura, B, faqe 81

¹³ Policia e Kosovës, *Doracaku i Parimeve dhe Procedurave*, Parimi P-10.01 (Shfrytëzimi i automjeteve të SHPK-së), Procedura, E, faqe 354.

3.5.5. Udhëzimi Administrativ nr. 06/2012 për Shkeljet, Masat dhe Procedurën Disiplinore në PK ka përcaktuar edhe shqiptimin e masave disiplinore varësisht nga shkelja e supozuar (shkeljet e lehta dhe të rënda)¹⁴. Nga gjithsej 57 procedura që kanë rezultuar me vendime për fajësi për dëmtim prone për vitin 2015, janë shqiptuar 70 masa disiplinore, prej të cilave, 43 sosh (61%) kanë rezultuar me ‘vërejtje me gojë’, 11 (15.7%) me ‘vërejtje me shkrim’, 15 (21.4%) me ndalesë të ngasjes për 1, 2, 3 dhe 6 muaj, si dhe një (1) apo 1.4% me ‘ndalesë në pagë 21% për dy muaj’. Viti 2016 gjithashtu ka rezultuar me 70 masa disiplinore, prej të cilave, 51 (72.8%) me ‘vërejtje me gojë’, shtatë (7) apo 10% me ‘vërejtje me shkrim’, dhjetë (10) apo 7% me ndalesë të ngasjes për 1, 2, 3 e 6 muaj, si dhe dy (2) apo 2.9% me ‘ndalesë në pagë në lartësi prej 10% dhe 21% për dy muaj’. Masat e shqiptuara disiplinore janë marrë nga autoritetet përkatëse për trajtim, shqyrtim, shqiptim dhe rekomandim të masave disiplinore, si rezultat i shkeljeve të dokumentuara ndaj përgjegjësve për dëmtim prone. IPK-ja inkurajon autoritetet përkatëse të strukturës policore që të vazhdohet me ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme ligjore dhe administrative, drejt disiplinimit të përdoruesve të automjeteve, në mënyrë që të ndikohet në përdorimin e drejtë të automjeteve dhe mbrojtjen e pronës së PK-së.

3.6. Kushtet teknike të automjeteve për pjesëmarrje në qarkullim

3.6.1. Doracaku i Parimeve dhe Procedurave të Policisë, ka përcaktuar disa artikuj që duhet të merren si operacional për automjetin policor (pajisja e radios, aparati zjarrfikës i kontrolluar çdo të dymbëdhjetin muaj, kutia e ndihmës së parë, goma rezervë dhe veglat për ndërrimin e saj, trekëndëshi i paralajmërimit dhe zinxhirët e borës të obligueshëm për periudhën e përcaktuar me ligjin e trafikut¹⁵). Ligji nr. 05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor¹⁶ ka përcaktuar pajisjet rezervë dhe shtesë, të cilat duhet t’i posedojë automjeti i udhëtarëve, kamioni ose autobusi gjatë qarkullimit në trafikun rrugor. IPK-ja është përcaktuar të verifikojë disa prej tyre që paraqesin relevancë për fushën dhe të përcaktuar me Ligjin e sipër përmendur dhe Parimin P-10.01. Nga 100 automjete të inspektuara në stacione policore, ka rezultuar se 99 prej tyre përmbushin standardin e pajisjes me kuti të ndihmës së parë (99%), 95 sosh përmbushin standardin e pajisjes me trekëndësh të paralajmërimit (95%) dhe 93 sosh përmbushin standardin e pajisjes me aparat për fikje zjarri (93%) (tabela nr. 8). Inspektorët vlerësojnë se mungesa e pajisjeve operationale ka ardhur për shkak të neglizhencës, mungesës së kontrollit adekuat në mirëmbajtjen e automjeteve dhe adresimin e tyre tek menaxherët. Mungesa e pajisjeve ndikon në paraqitjen e vështirësive në marrjen e masave drejt mirëmbajtjes së duhur të automjeteve.

Tabela nr. 8. Të dhëna përmblledhëse mbi gjendjen e pajisjeve dhe dokumenteve operationale në automjetet e inspektuara të stacioneve të inspektuara						
Numri	Pajisjet dhe dokumentet operationale					
	Aparat për fikje zjarri	Kutia e ndihmës së parë	Trekëndësh paralajmërimi	Çerfifikatë regjistrimi	Polica e sigurimit	Raporti i aksidentit
Automjete	93	99	95	100	95	92
(%)	93	99	95	100	95	92

¹⁴ Policia e Kosovës, *Udhëzimi Administrativ nr. 06/2012 për Shkeljet, Masat dhe Procedurat Disiplinore në PK*, Kapitulli V-Masat disiplinore dhe autoriteti vendimmarrës, nenet 44 dhe 45, faqe 55 dhe 58.

¹⁵ Policia e Kosovës, *Doracaku i Parimeve dhe Procedurave të Policisë*, Parimi P-10.01, kapitulli J, paragrafi 1.

¹⁶ Kuvendi i Republikës së Kosovës, *Ligji nr. 05/L-088 për Rregullat në Trafikun Rrugor*, neni 207, faqe 90.

3.6.2. Ligji nr. 05/L-088 për Rregullat e Trafikur Rrugor¹⁷ ka përcaktuar se çfarë dokumentesh duhet të mbajë shoferi gjatë drejtimit të mjetit. Parimi P-10.01 përcakton se drejtuesit dhe mbikëqyrësit e automjetit janë përgjegjës për sigurimin e dokumenteve operacionale, që të jenë në automjetin e tyre (kartela e sigurimit, formulari i mirëmbajtjes të automjetit, formulari i prishjes së automjetit, formulari i udhëtimit dhe raporti i drejtuesit të automjetit)¹⁸. IPK-ja është përcaktuar të verifikojë disa prej tyre që paraqesin relevancë për fushën dhe të përcaktuar me Ligj dhe Parimin P-10.01 të Doracakut. Nga 100 automjete të inspektuara në stacione policore, ka rezultuar se 100 prej tyre përmbushin standardin e pajisjes me çertifikatë regjistrimi (100%), 95 sosh përmbushin standardin e pajisjes me policë të sigurimit (95%) dhe 92 sosh përmbushin standardin e pajisjes me raport të aksidentit (92%). Inspektorët vlerësojnë se mungesa e dokumenteve operacionale ka ardhur për shkak të neglizhencës dhe mungesës së kontrollit adekuat në mirëmbajtjen e automjeteve. Mungesa e dokumenteve ndikon në një etikë apo kulturë jo të duhur të paraqitjes policore.

Rekomandimi nr. 12

IPK-ja u rekomandon përdoruesve të automjeteve dhe mbikëqyrësve që t'i kushtojnë kujdesin e duhur pajisjes së automjeteve me pajisjet dhe dokumentet e nevojshme operacionale, me qëllim të shmangies së vështirësive në mirëmbajtjen e tyre dhe kontrollit të vazhdueshëm të tyre mbi validitetin e regjistrimit dhe sigurimit.

¹⁷ Kuvendi i Republikës së Kosovës, *Ligji nr. 05/L-088 për Rregullat në Trafikun Rrugor*, neni 203, faqe 87.

¹⁸ Policia e Kosovës, *Doracaku i Parimeve dhe Procedurave të Policisë*, Parimi 10.01, kapitulli K, paragrafi 1

4. Plani i përbushjes së rekomandimeve

4.1. Plani për përbushjen e rekomandimeve

4.1. Mbi bazën e gjetjeve, IPK-ja ka dhënë një numër rekomandimesh dhe pas komenteve të ofruara nga menaxhmenti policor, është vendosur që ato të realizohen sipas Planit të veprimit të prezantuar në tabelën e mëposhtme.

Nr.	Rekomandimi	Niveli i prioritetit	Komentet e strukturës policore	Plani i veprimit
1.	IPK-ja u rekomandon të gjithë mbikëqyrësve, zyrtarëve të mirëmbajtjes dhe përdoruesve të automjeteve zyrtare në stacione policore, që gjithherë të ndërmarrin veprimet e nevojshme rreth deklarimit dhe procedimit të automjeteve zyrtare në procedurë të mirëmbajtjes, kur vërejnë se gjendja teknike e tyre nuk përkon me standardin e kërkuar, me qëllim të aftësisë të tyre operativ, ofrimit të sigurisë në rrugë dhe ngritjes së imazhit policor.	I (një)	Për të evituar gjendjen e gjetur, Departamenti i Shërbimeve Mbështetëse ka kërkuar raportime javore rreth gjendjes së automjeteve. Qëllimi i këtyre raporteve është që edhe mbikëqyrësit e të gjitha niveleve të jenë të njoftuar me gjendjen e automjeteve në njësitë e tyre. Si duket këto raporte nuk janë marrë seriozisht.	Menjëherë do të informohet zinxhiri komandues për ndërmarrjen e masave urgjente për eliminimin e këtyre neglizhencave. Si kontroll i përmirësimit të kësaj gjendjeje, Departamenti për Shërbime Mbështetëse do të kujdeset që të dërgoj ekipe në terren për verifikim të gjendjes dhe sipas nevojës do të ndërmerren masa disiplinore. Planifikohet që gjendja të normalizohet në mars të vitit 2018.
2.	IPK-ja i rekomandon menaxhmentit të lartë të PK-së që në planet e ardhshme strategjike të vendosin me prioritet objektiva dhe veprime që orientojnë organizatën në adresimin e çështjeve që ndihmojnë në mirë funksionimin e Parkut të automjeteve.	I (një)	PK-ja vazhdimisht planifikon (Plani Strategjik Zhvillimor 2016 – 2020, objektiva 1.1) dhe i qaset problematikës me prioritet, mirëpo në mungesë të buxhetit për zëvendësim të automjeteve, çdo gjë është e kotë. Flota Operative e PK-së siç e keni vërejtur, në mungesë të buxhetit dhe për shkak të procedurave të komplikuar të prokurimit, është vjetëruar tej mase dhe	PK-ja vazhdimisht adreson gjendjen e krijuar dhe kërkon buxhet shtesë për freskimin e Flotës operative me automjete të reja. Sigurimi i buxhetit varet nga Qeveria dhe është jashtë kompetencave të PK-së. Në momentin që sigurohet buxhet, ky rekomandim implementohet.

			ka kaluar të gjitha kriteret e jetëgjatësisë. 80% e automjeteve janë më të vjetra se 7 vite dhe kanë të kaluara më tepër se 250.000 km.	
3.	IPK-ja i rekomandon Zyrtarët Kryesor Administrativ që të shtyjë proceset drejt tjetërsimit të kësaj pasurie, bazuar në kriteret dhe procedurat e përcaktuara me Rregulloren (MF) nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë Jofinanciare në Organizatat Buxhetore dhe Planin e zëvendësimit të automjeteve, për të siguruar që PK-ja të ketë një Park funksional të automjeteve, të mbështetur me fond të mjaftueshëm të automjeteve dhe të mirëmbajtur në mënyrë efikase dhe ekonomike.	I (një)	Automjeti është pajisje primare e punës policore dhe mungesa e saj pamundëson arritjen e objektivave. Pamundësia e zëvendësimit me automjete të reja ka detyruar PK-në që të shfrytëzojë automjetet edhe pas kalimit të kriterëve të jetëgjatësisë. Në rastet kur automjeti shkatërrohet dhe nuk ka mundësi riparimi atëherë hyn në procedurë për tjetërsim.	Procedurat për tjetërsim kanë filluar dhe janë në proces në bashkëpunim me Ministrinë e Administratës Publike sipas vendimit të Kryeministrit.
4.	IPK-ja u rekomandon komandantëve të stacioneve që të ushtrjnë kontroll më të shpeshtë mbi përdoruesit e automjeteve dhe zyrtarët kompetent të mirëmbajtjes, në mënyrë që automjetet gjatë ekspozimit në rrugë, të paraqesin imazh pozitiv para qytetarëve.	I (një)	E lidhur me rekomandimin nr. 1	Rekomandimi do të përcillet për të pasur kujdes më të shtuar. Ekipet inspektuese do të kujdesen për verifikim të implementimit.
5.	IPK-ja u rekomandon mbikëqyrësve, zyrtarëve të mirëmbajtjes së automjeteve dhe përdoruesve të tyre që të kujdesen për gjendjen teknike të automjeteve dhe sipas nevojave t'i dërgojnë në proces të mirëmbajtjes, duke mbrojtur dhe u kujdesur për to, si asete me rëndësi operationale.	I (një)	E lidhur me rekomandimin nr. 1	Rekomandimi do të përcillet për të pasur kujdes më të shtuar. Ekipet inspektuese do të kujdesen për verifikim të implementimit.
6.	IPK-ja u rekomandon mbikëqyrësve, zyrtarëve të mirëmbajtjes së automjeteve	I (një)	PK-ja ka filluar dhe është duke përfunduar projektin e	Flota operative do të kujdeset që aty ku servisi rajonal është funksional,

	<i>dhe përdoruesve të tyre që në rastet kur disa lloje të mirëmbajtjeve mund të kryhen në servise rajonale, të shmangin situatat e pa nevojshme, duke ngarkuar servisin qendror me angazhime shtesë për mirëmbajtjen e automjeteve të tyre.</i>		<i>decentralizimit të servisit për mirëmbajtjen e automjeteve. Pajisjet dhe objektet janë të gatshme vetëm pritet rekrutimi i personelit. Po ashtu, dy ekipe mobile të Flotës, me orar vizitajnë DRP-të dhe kryejnë riparime te nevojshme.</i>	<i>automjetet e atij regjioni të mos vijnë në servisin qendror për riparime që mund të kryhen në DRP. Planifikojmë që këto servise të funksionalizohen të gjitha deri në fund të 2018.</i>
7.	<i>IPK-ja u rekomandon të gjithë menaxherëve policorë të stacioneve, drejtorive, divizioneve dhe departamenteve që të shtojnë përpjekjet e tyre në mënyrë që personeli kompetent i shërbimeve mbështetëse, të tërheqë në kohë të duhur automjetet nga procesi i mirëmbajtjes, duke mundësuar ngritjen e fuqisë aktive apo fondit të automjeteve policore në funksion.</i>	<i>I (një)</i>	<i>Vërejtja në fjalë do të përcillet tek kompetentët.</i>	<i>Departamenti për Shërbime Mbështetëse do të kujdeset për sanksionimin e atyre që nuk respektojnë afatin e tërheqjes së automjeteve të riparuar.</i>
8.	<i>IPK-ja i rekomandon menaxhmentit të Flotës operative, Drejtorit të Logjistikës dhe Udhëheqësit të Departamentit të Shërbimeve Mbështetëse që të shqyrtojnë mundësinë në bashkëpunim me Drejtorinë e Teknologjisë Informative, në ngritjen e kapaciteteve të Bazës së të dhënave, në mënyrë që të dhënat mbi mirëmbajtjen e automjeteve të jenë më të plota, duke mundësuar lehtësim në marrjen e vendimeve në interes të Parkut të automjeteve.</i>	<i>I (një)</i>	<i>Nuk ka koment</i>	<i>PK-ja ka filluar shfrytëzimin e sistemit PRIMs për menaxhimin e personelit dhe resurseve. Deri në qershor të vitit 2018 planifikohet që të përdoret vetëm ky sistem për menaxhimin e të dhënave në Flotë.</i>
9.	<i>IPK-ja u rekomandon menaxherëve policorë që të shtojnë përpjekjet në sigurimin e masave adekuate dhe ngritjen e përgjegjësisë së vartësve gjatë shfrytëzimit të automjeteve, duke konsideruar kujdesin ndaj automjeteve si angazhim për të</i>	<i>I (një)</i>	<i>E lidhur me rekomandimin nr. 1</i>	<i>Rekomandimi do të përcillet për të pasur kujdes më të shtuar. Ekipe inspektuese do të kujdesen për verifikim të implementimit.</i>

	<i>ruajtur pronën policore si aset që mundëson kryerjen e detyrave operative.</i>			
10.	<i>IPK-ja u rekomandon menaxherëve dhe zyrtarëve kompetent të mirëmbajtjes së automjeteve të tri niveleve të strukturës organizative policore, që të ngrisin performancën policore në raportimin me kohë të aksidenteve dhe incidenteve, në drejtim të ngritjes së përgjegjësisë në ruajtjen e pronës policore, ngritjes së kapaciteteve aktive të Parkut të automjeteve dhe minimizimit të tendencës për shmangie apo mos deklarim të rasteve të ndodhura.</i>	<i>I (një)</i>	<i>Nuk ka koment</i>	<i>Rekomandimi do të përcillet për të pasur kujdes më të shtuar. Ekipet inspektuese do të kujdesen për verifikim të implementimit.</i>
11.	<i>IPK-ja u rekomandon mbikëqyresve që të ndërmarrin veprimet e nevojshme drejt disiplinimit të ngasësve policorë të automjeteve, me qëllim të ngritjes së vetëdijes policore në trajtimin si dhe shfrytëzimin e duhur të pasurisë policore.</i>	<i>I (një)</i>	<i>E lidhur me rekomandimin nr. 9</i>	<i>Rekomandimi do të përcillet për të pasur kujdes më të shtuar. Ekipet inspektuese do të kujdesen për verifikim të implementimit.</i>
12.	<i>IPK-ja u rekomandon përdoruesve të automjeteve dhe mbikëqyresve që t'i kushtojnë kujdesin e duhur pajisjes së automjeteve me pajisjet dhe dokumentet e nevojshme operacionale, me qëllim të shmangies së vështirësive në mirëmbajtjen e tyre dhe kontrollit të vazhdueshëm të tyre mbi validitetin e regjistrimit dhe sigurimit.</i>	<i>I (një)</i>	<i>E lidhur me rekomandimin nr. 1</i>	<i>Rekomandimi do të përcillet për të pasur kujdes më të shtuar. Ekipet inspektuese do të kujdesen për verifikim të implementimit.</i>

Shtojcat

Shtojca 1. Të dhëna mbi nivelin e përmbushjes së rekomandimeve nga inspektimi i kaluar				
Nr.	Gjetjet nga inspektimi i mëparshëm (viti 2014) Inspektimi: Kujdesi i punonjësve policorë për automjetet zyrtare, nr. 05/2014			Niveli i zbatimit po/jo
	Rekomandimi i dhënë	Komentet e strukturës policore	Afatet për zbatim	
1.	IPK-ja i rekomandon mbikëqyrësit dhe përdoruesit e automjeteve të stacioneve t'i kushtojnë kujdesin e duhur mirëmbajtjes ditore të automjeteve duke përdorur formularë unik të kontrollit ditor, kurse menaxherëve të stacioneve, të ushtrojnë kontroll në drejtim të respektimit të procedurave të mirëmbajtjes ditore të automjeteve.	I tërë rekomandimi duhet filluar menjëherë. Përgjegjës komandantët e stacioneve dhe njësisive.	Java e parë dhe e dytë e shtatorit	Vlerësimi nga IPK-ja: Përgjithësisht është realizuar
2.	IPK-ja i rekomandon mbikëqyrësit e stacioneve policore që të ushtrojnë kontroll në drejtim të respektimit të ndalesës për pirjen e duhanit në automjete policore, duke mos përjashtuar edhe inicimet disiplinore ndaj shkelësve të ndalesave.	I tërë rekomandimi duhet filluar menjëherë. Përgjegjës komandantët e stacioneve.	Java e parë e shtatorit	Vlerësimi nga IPK-ja: Plotësisht është realizuar
3.	IPK-ja i rekomandon menaxhmenteve të stacioneve policore dhe logjistikave rajonale që të sigurohen se automjetet që janë në funksion, të jenë të pajisura me pajisjet dhe dokumentet operacionale.	I tërë rekomandimi duhet filluar menjëherë. Përgjegjës Logjistika rajonale	Muaji shtator	Vlerësimi nga IPK-ja: Përgjithësisht është realizuar
4.	IPK-ja u rekomandon drejtuesve të automjeteve që të respektojnë rregullat e trafikut (përdorimi i rripat të sigurisë gjatë ngasjes) gjatë kohës sa janë pjesëmarrës të trafikut, kurse mbikëqyrësve, të organizojnë kontrolle të kohëpaskohshme për të ngritur performancën policore në respektimin e rregullave të trafikut.	I tërë rekomandimi duhet filluar menjëherë. Përgjegjës stafi komandues rajonal dhe komandantët e stacioneve.	Java e parë dhe e dytë e shtatorit	Vlerësimi nga IPK-ja: Nuk është përmbushur
5.	IPK-ja i rekomandon personelit të ZRS-së së FO-së që të përkushtohet në respektimin e afateve kohore për të njoftuar në kohën e duhur njësitë shfrytëzuese të automjeteve për skadimin e regjistrimeve të tyre.	I tërë rekomandimi duhet filluar menjëherë.	Muaji shtator	Vlerësimi nga IPK-ja: Nuk është përmbushur
6.	IPK-ja i rekomandon personelit të ZRS-së dhe zyrtarëve të transportit,	I tërë rekomandimi duhet filluar menjëherë.	Muaji shtator	Vlerësimi nga IPK-ja:

	<i>logjistikës dhe mirëmbajtjes së automjeteve të stacioneve që të respektojnë afatet e regjistrimit të automjeteve zyrtare policore, kurse këtyre të fundit, të kryejnë me kohë kontrollet teknike, për të proceduar me kohë me hapat tjerë të sigurimit dhe regjistrimit.</i>			<i>Nuk është përmbushur</i>
7.	<i>IPK-ja u rekomandon njësisë shfrytëzuese të automjeteve që në rastet e aksidentimit të automjeteve të tyre, të raportojnë me kohë në FO.</i>	<i>I tërë rekomandimi. Asnjë lëndë nuk do të pranohet në Zyrën e Aksidenteve me vonesë dhe e pakompletuar.</i>	<i>Java e dytë dhe tretë e shtatorit</i>	Vlerësimi nga IPK-ja: <i>Nuk është përmbushur</i>
8.	<i>IPK-ja u rekomandon njësisë shfrytëzuese të automjeteve që me rastin e raportimit të aksidenteve në Flotë, të kompletojnë dosjet fizike me tërë dokumentacionin e paraparë me PSO.</i>	<i>I tërë rekomandimi Lëndët e pakompletuara dhe me vonesë nuk do të pranohen pa arsyetim me shkrim.</i>	<i>Java e dytë dhe e tretë e muajit shtator</i>	Vlerësimi nga IPK-ja: <i>Nuk është përmbushur</i>

Shtojca 2. Të dhëna mbi nivelin e përmbushjes së rekomandimeve nga inspektimi i kaluar				
Nr.	Gjetjet nga inspektimi i mëparshëm (viti 2015)			Niveli i zbatimit po/jo
	Inspektimi: Menaxhimi i flotës së automjeteve dhe logjistikës, nr. 02/2015	Rekomandimi i dhënë	Komentet e strukturës policore	
1.	<i>IPK-ja i rekomandon menaxhmentit të Flotës operative që të kryejë analiza detale të cilat do të përmbajnë indikatorë që mund të pasqyrojnë performancën e NJAS-it në ofrimin e shërbimeve të mirëmbajtjes dhe në bazë të tyre të mund të identifikojnë faktorët apo shkaktarët që ndikojnë në rënien e efikasitetit të punës brenda Njësisë.</i>	<i>E gjetura qëndron. Me qenë raporti rezulton në rënien e performancës nëpër vite si indikatorë kryesor janë: automjetet e vjetërsuar, numri më vogël i stafit në krahasim me vitet e mëhershme, buxheti më i limituar- zvogëluar, mungesa e lidhjes së kontratave për pjesë rezervë.</i>	<i>Adresimi i kërkesave për plotësimin e pozitive të lira për personel, zëvendësimi i automjeteve , kërkesa për ngritje të buxhetit, analizë më e detajuar e pjesëve të nevojshme dhe investimeve nëpër vite.</i>	Vlerësimi nga IPK-ja: <i>Pjesërisht është realizuar</i>
2.	<i>IPK-ja i rekomandon Drejtorin e Drejtorisë së Logjistikës dhe Udhëheqësit të Auto-servisit që të rrisin nivelin e kontrollit dhe mbikëqyrë ekipet e mekanikëve sa i përket respektimit të rregullativës në fuqi, si dhe për t'u siguruar se ato bashkëpunojnë kur është e nevojshme me përgjegjësit e Depos së pjesëve rezervë, mbi mundësitë e sigurimit të pjesëve rezervë nga Depoja para se automjetet të dërgohen tek operatorët ekonomikë.</i>	<i>E gjetura qëndron Kontratat aktuale përfaqësojnë edhe furnizimin me pjesë rezervë si dhe montimin me një çmim të volitshëm meqenëse furnizimi dhe montimi bëhet te i njëjti kontraktor, duke llogaritur volumin e punës që është i lartë, vetura shkon te kontraktori ku bëhet edhe furnizimi dhe montimi për pjesët në fjalë dhe me qëllim që veturat të funksionalizohen sa më shpejt dhe mos të mbesin në pritje në Servisin e Flotës Operative, zakonisht veturat kur ekziston pjesë në depo</i>	<i>Inicimi i kërkesave rreth mirëmbajtjes dhe servisimit të automjeteve të PK-së ka filluar të bëhet vetëm për furnizim me pjesë ndërsa montimin e bëjnë zyrtarët e Flotës Operative</i>	Vlerësimi nga IPK-ja: <i>Përgjithësisht është realizuar</i>

		<i>rregullohen në Flotën Operative përjashtim bëjnë rastet kur numri i tyre është i lartë në krahasim me kapacitetet e Flotës disa nga ato vetura shkojnë tek kontraktori.</i>		
3.	<i>IPK-ja i rekomandon menaxhmentit të NJASit që të shqyrtojë mundësinë që në bashkëpunim me ekspertët e IT-së, të shtyjnë në funksion përdorimin e një aplikacioni të ri për gjenerimin e formularëve të ri të kartelave të punës, duke respektuar rregullat mbi përdorimin e gjuhëve zyrtare dhe që do të mund të paraqiste informacionin e duhur mbi procedurën që ndiqet dhe personat që lidhen me aprovimet brenda formularit.</i>	<i>E gjetura qëndron. Drejtoria e Logjistikës ka adresuar kërkesën në Drejtorinë e TIK-ut mirëpo nga kjo Drejtori kemi pranuar konfirmimin se sa i përket përkthimit apo ndryshimeve tjera nuk mund të bëhen pasi që nuk kane dokumentacion të ndërtimit të sistemit, nuk ka source code dhe teknologjia me të cilën është zhvilluar sistemi është shumë i vjetër dhe nuk ka përkrahje nga Microsoft</i>	<i>Pritet të implemento het deri në fund të vitit 2015, në momentin e funksionalizimit të Projektit PRIMS (Donacion nga SHBA)</i>	Vlerësimi nga IPK-ja: <i>Nuk është përmbushur</i>